



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 15 regjistër (JR)
Datë 11.09.2018

Nr. 1 i vendimit
Datë 31.01.2019

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga:

Sokol Çomo	Kryesues
Albana Shtylla	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 31.01.2019, ora 12:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 15, datë 11.09.2018, që i përket:

Ankues: Subjekti i rivlerësimit Artan Lazaj, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Objekti: Shqyrtimi i vendimit nr. 34, datë 11.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Baza ligjore: Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 63 dhe 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, fillimisht në dhomë këshillimi dhe më pas në seancë gjyqësore publike, me praninë e subjektit të rivlerësimit dhe avokatit të tij, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), dëgjoi subjektin e rivlerësimit Artan Lazaj, i cili përfundimisht kërkoi prishjen e vendimit nr. 34, datë 11.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), duke kryer procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Artan Lazaj, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 58, pika 1, shkronja “c” e 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 34, datë 11.07.2018, ka vendosur:
“1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Lazaj, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohej pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.”

II. Shkaqet e ankimit

2. Kundër vendimit nr. 34, datë 11.07.2018, të Komisionit ka bërë ankim subjekti i rivlerësimit Artan Lazaj (në vijim subjekti i rivlerësimit) në mbështetje të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve 63 e 65 të ligjit nr. 84/2016, duke kërkuar prishjen e vendimit nr. 34, datë 11.07.2018, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë, me parashtrimin këtyre shkaqeve:
 - 2.1 Komisioni, para dhe gjatë seancës dëgjimore, ka cenuar rëndë proceduralisht ligjin dhe Kushtetutën, sepse ka vendosur të përfundojë hetimin administrativ kryesisht, vetëm për kriterin e pasurisë. Vlerësimi përfundimtar i Komisionit, bazuar vetëm në hetimin e një kriteri përbën një shkelje të rëndë të nenit Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim KEDNJ).
 - 2.2 Subjekti i rivlerësimit kundërshton vendimin nr. {***} prot., datë 29.06.2018, të trupit tjetër gjyqësor të Komisionit, të caktuar me short, i cili ka rrëzuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit Artan Lazaj për përjashtimin e trupit gjyqësor të çështjes, me pretendimin se është arsyetuar vetëm mbi shkakun e mospranimit të kërkesës, pa marrë në analizë shkaqet e tjera.
 - 2.3 Subjekti i rivlerësimit kundërshton bashkë me vendimin përfundimtar, vendimin e ndërmjetëm të Komisionit, datë 02.07.2018, i cili ka rrëzuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e anëtares së trupit gjyqësor Brunilda Bektoshi, njëkohësisht kryesuese e këtij trupi, sepse kryesuesja, menjëherë pas paraqitjes së kërkesës, shprehu opinionin e saj se kërkesa nuk duhej të pranohet; trupi gjyqësor nuk pranoi kërkesën e subjektit për të dhënë sqarime mbi

kërkesën e paraqitur dhe madje ky debat është fshirë nga incizimi i seancës dëgjimore; trupi gjykues ka marrë vendimin në kundërshtim me nenin 75 të Kodit të Procedurës Civile, duke mos ia kaluar kërkesën për shqyrtim një trupi tjetër gjykues, si dhe në kundërshtim me nenin 27 të ligjit nr. 84/2016.

2.4 Gjatë procesit të rivlerësimit, ndryshe nga sa parashikon neni 52 i ligjit nr. 84/2016, provat apo të dhënat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk janë vlerësuar dhe analizuar nga Komisioni, sepse në seancë dëgjimore u prezantuan prej relatorit rezultatet e hetimit paraprak, me të cilat subjekti ishte njohur tashmë.

2.5 Shpallja e vendimit përfundimtar të Komisionit, 9 ditë pas zhvillimit të seancës dëgjimore, është bërë në shkelje të afateve procedurale të parashikuara në nenin 55, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore, maksimalisht 5 ditë, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

2.6 Subjekti pretendon se apartamentin me sipërfaqe 158,1 m² në Rrugën {***}, Tiranë, (në vijim apartamenti 158,1 m²) nuk e ka deklaruar në vitin 2010 për arsye të harresës, por e ka deklaruar në vitin 2011, pasi në këtë vit ka filluar të jetojë në këtë apartament, vit kur kanë përfunduar punimet dhe mobilimi nga shoqëria {***} SHPK. Vlera 120.000 euro, e deklaruar në vitin 2011, përfaqëson vlerën e rënë dakord fillimisht me shoqërinë {***} SHPK, ndërsa më vonë kanë rënë dakord që kjo shoqëri të kryente dhe mobilimin e apartamentit. Vlera përfundimtare është 129.000 euro, sa është deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit 2017. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se në vitin 2011 ka deklaruar pjesën takuese 100% të këtij apartamenti, ndërsa në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit 2017 ka deklaruar 25%, sepse familja e tij përbëhet nga katër anëtarë, me të cilët ai ndan në mënyrë të barabartë çdo pasuri të paluajtshme e të luajtshme.

2.7 Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se ka mungesë burimesh për të blerë pasurinë apartament 158,1 m², duke pretenduar se ai është blerë nga një kredi e përfutur nga Raiffeissen Bank në shumën 29.000 euro, shumë e kaluar te shoqëria {***} SHPK, si dhe nga një pjesë e vlerës së shitjes së një apartamenti në pronësi të tij në Rrugën e {***}, me sipërfaqe 120 m², në shumën 50.000 euro, pagesë e kryer nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare (në vijim BKT) në llogarinë e shoqërisë {***} SHPK, ndërsa pjesa tjetër e mbetur e detyrimit të paguar prej 50.000 eurosh¹ përbëhej nga kursimet prej pagave dhe shuma prej 2.040.000 lekësh, e cila ishte pjesë e të ardhurave të përfutura po nga shitja e apartamentit në Rrugën {***}.

2.8 Hetimi dhe gjykimi i Komisionit kanë qenë paragjykes në lidhje me citimin e burimit të të ardhurave - “Nga emigracioni” - në pagesën e bërë në BKT prej subjektit të rivlerësimit në favor të {***} SHPK, në shumën 50.000 euro. Edhe pse subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova se ky deklarim ka qenë një gabim i BKT-së, sërish Komisioni gjatë seancës dëgjimore e ka relatuar shënimin “Nga emigracioni” si relativ korrekt.

2.9 Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit në lidhje me ish-pasurinë e tij apartament 120 m², në rrugën {***} (në vijim apartamenti 120 m²), duke pretenduar se në lidhje me datën e kontratës së blerjes ka kryer gabim material, ndërsa deklarimi i vlerës 55.000 euro për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2004 është lapsus i sqaruar edhe pranë ILDKPKI-së në vitin 2014. Ky apartament është shitur në vlerën 90.000 euro te shtetasit S.A. dhe N.A. Megjithëse ka lidhur dy kontrata për shitjen e këtij apartamenti, me të njëjtat palë, me të njëjtin çmim dhe përpara të njëjtit noter, çmimin e shitjes e ka përfutur vetëm një herë. Kontrata e parë ka qenë kontratë premtim shitjeje dhe blerësit i kanë likuiduar shumën 2.500.000 lekë,

¹ Subjekti pretendon se ka paguar: 29.000 euro + 50.000 euro + 50.000 euro = 129.000 euro.

ndërsa kontrata e dytë ka qenë kontratë shitjeje përfundimtare dhe në ditën e lidhjes së saj ka përfituar pjesën e mbetur të detyrimit prej 8420000 lekësh.

2.10 Konkluzioni i hetimit të Komisionit në lidhje me apartamentin në Bulqizë, ish-pasuri e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nuk është i drejtë, pasi mosdeklarimi i këtij apartamenti dhe i të ardhurave nga shitja e tij është bërë me vetëdije, pasi me realizimin e martesës, bashkëshortët kanë qenë dakord të respektonin traditat dhe të drejtën zakonore të krahinës së bashkëshortes, duke mos përfituar asgjë nga pasuria e prindërve të saj.

2.11 Rezultati i hetimit të Komisionit në lidhje me apartamentin në Vlorë, në ish-bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit, nuk është i drejtë, pasi deklarimet e subjektit në vite dhe në deklaratën e rivlerësimit në lidhje me këtë apartament dhe pjesën takuese në pronësi të tij, janë deklarime të gabuara, por jo të rreme dhe të qëllimshme. Apartamentin dhe vlerën e përfituar nga shitja e tij, subjekti ka harruar ta deklarojë në vitin 2003.

2.12 Konkluzionet e hetimit të Komisionit në lidhje me pasurinë tokë me sipërfaqe 1.000 m², në {***}, Vlorë, nuk janë të drejta, pasi mosdeklarimi i burimit në deklaratën e rivlerësimit ka qenë harresë dhe neglizhencë nga ana e subjektit të rivlerësimit, por burimi i të ardhurave është tërësisht i justifikuar nga të ardhurat familjare. Në lidhje me deklarimin e pjesëve takuese, subjekti pretendon se në deklaratën e rivlerësimit ka deklaruar hipotetikisht pjesët, pasi pyetëtori për plotësimin e kësaj deklarate ndryshon nga parashikimet e Kodit të Familjes.

2.13 Konkluzionet e Komisionit, në lidhje me automjetin {***}, në ish-pronësi të tij, kundërshtohen nga subjekti me pretendimin se Komisioni nuk ka pranuar asnjë provë, e cila ka formën e kërkuar nga ligji, sa i përket blerjes nëpërmjet privatizimit dhe shitjes së kësaj makine në vlerën 5000 euro. Vlera e shitjes, pavarësisht nga çmimi i blerjes, është vlera reale e tregut, pasi makina ka qenë në gjendje shumë të mirë teknike.

2.14 Komisioni njëanshmërisht e në mënyrë arbitrare nuk ka pranuar sqarimet e subjektit të rivlerësimit, për sa u përket pagesave të arsimimit të vajzës së tij. Subjekti nuk i ka deklaruar këto shpenzime në deklaratat e pasurisë, duke qenë se ato janë të justifikuara nga kursimet familjare ndër vite.

2.15 Subjekti pretendon se nuk është i qartë për metodologjinë e përdorur nga Komisioni në analizën e tij financiare dhe për këtë arsye ka kryer vetë një analizë financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të tij që nga viti 1994 e deri në vitin 2016, nga e cila rezulton se në çdo vit disponibiliteti i burimeve financiare ka qenë i mjaftueshëm për të përballuar shpenzimet e kryera nga familja e tij dhe për krijimin e kursimeve ndër vite.

III. Rrethanat e çështjes

3. Nga shqyrtimi i akteve të administruara, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Artan Lazaj ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Bulqizë në periudhën janar 1994 - 28 shkurt 1996, detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë në periudhën 29 shkurt 1996 - 15 janar 1999, detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër në periudhën 16 janar 1999 - 1 shkurt 2009, detyrën e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në vijim KQZ) në periudhën 2 shkurt 2009 - 17 tetor 2012. Pas kësaj detyre, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në periudhën 19 dhjetor 2012 e në vazhdim. Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi, duke qenë kandidat për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

4. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (në vijim ILDKPKI), bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procedurës së kontrollit ka hartuar një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, duke konstatuar se:
 - a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
 - b) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - d) ka kryer deklarim të rremë;
 - e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
5. Komisioni ka kryer procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Artan Lazaj ka bërë deklarim të pamjaftueshëm dhe nuk ka dhënë shpjegime bindëse, referuar parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

6. Në shqyrtim dhe vlerësim të procedurës administrative të ndjekur gjatë procesit të rivlerësimit nga Komisioni dhe shkaqeve të ankimit me natyrë procedurale që ka paraqitur subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim Kolegji), bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtoi ankimin e subjektit të rivlerësimit në dhomë këshillimi, më datë 09.01.2018.
7. *Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar vendimin nr. {***} prot., datë 29.06.2018, të trupit tjetër gjykues të Komisionit, të caktuar me short, i cili ka rrëzuar kërkesën e subjektit për përjashtimin e trupit gjykues të çështjes, me pretendimin se është arsyetuar vetëm mbi shkakun e mospranimit të kërkesës, pa marrë në analizë shkaqet e tjera.* Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nga aktet e fashikullit gjyqësor, rezulton që në seancën dëgjimore të datës 28.06.2018 në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur “Kërkesë për përjashtimin nga shqyrtimi i kësaj çështjeje të trupit gjykues”, për arsye se ky trup gjykues duke refuzuar kërkesën e subjektit për të revokuar vendimin për caktimin e seancës dëgjimore me qëllim kryerjen e hetimit për të tria kriteret e rivlerësimit, ka treguar njëanshmëri të theksuar dhe ka paragjykuar negativisht rezultatin e gjykimit mbi subjektin e rivlerësimit, duke shfaqur hapur karakterin formal të seancës dëgjimore dhe, për rrjedhojë, e vetmja vendimmarrje ndaj subjektit ishte shkarkimi. Trupi gjykues ka vendosur administrimin e kërkesës, e cila është shqyrtuar nga një trup tjetër gjykues² i Komisionit, i caktuar me short. Me vendimin nr. 5001 prot., datë 29.06.2018, trupi gjykues i caktuar për shqyrtimin e kërkesës së subjektit ka vendosur rrëzimin e saj, si të pabazuar në ligj e prova. Në vendim, trupi gjykues ka shprehur rrethanat saktësisht siç i ka paraqitur edhe vetë subjekti në kërkesën e tij, ndërsa në pjesën arsyetuese shprehet se vendimi për të ftuar subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore për një ose disa prej kriterëve, është detyrë funksionale e Komisionit, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit, dhe në asnjë rast ushtrimi i detyrës dhe/ose mënyra e interpretimit dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi nuk përbën paragjykim dhe cenim të paanësisë së trupit gjykues e për rrjedhojë nuk përbën shkak për përjashtim të anëtarëve të trupit. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kërkesa e subjektit

² Komisioni me vendimin nr. 36, datë 28.06.2018, vendosi ngritjen e trupit tjetër gjykues për shqyrtimin e kërkesës së subjektit.

është analizuar nga Komisioni në përputhje të plotë me objektin e saj dhe është vlerësuar drejt, në përputhje me bazën ligjore në fuqi.

8. *Lidhur me shkakun e paraqitur në ankim nga subjekti i rivlerësimit, për shkeljen nga Komisioni të nenit 75 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, pasi kërkesa e tij për përjashtimin e komisioneres Brunilda Bekteshi nga shqyrtimi i çështjes nuk u shqyrtua nga një trup gjykues i caktuar me short, i ndryshëm nga ai që ka dhënë vendimin nr. 34, datë 11.07.2018, trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 dhe nenin 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 49/2012, i ndryshuar) vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, për të debatuar nëse shkelja e rëndë procedurale e pretenduar nga ai, ka ndikuar apo jo në bazueshmërinë e vendimit të Komisionit, si dhe për të vazhduar shqyrtimin e mëtejshëm të ankimit, duke i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të dëgjohet për të gjitha pretendimet e tij, lidhur me një rivlerësim të bazuar vetëm në fakte dhe në ligj.*
9. Subjekti i rivlerësimit, në seancë gjyqësore publike³ pretendoi se mosshqyrtimi i kërkesës së tij për përjashtimin nga gjykimi i mëtejshëm i komisioneres Bekteshi nga një trup tjetër gjykues, është marrë në kundërshtim me nenet 74 dhe 75 të Kodit të Procedurës Civile, me nenin 27 të ligjit nr. 84/2016, me rregulloren e Komisionit dhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Ai pretendoi gjithashtu se vendimi nr. 34, datë 11.07.2018, i Komisionit ishte marrë nën ndikimin direkt jo vetëm të kryesueses, por edhe të anëtarëve të tjerë të trupit gjykues, të cilët kishin pranuar me ndërjegje këtë shkelje të rëndë procedurale, për pasojë ky vendim është i pavlefshëm.
10. Trupi gjykues vlerëson se shqyrtimi i kërkesës së subjektit të rivlerësimit për përjashtimin nga gjykimi i mëtejshëm i komisioneres Bekteshi nga i njëjti trup gjykues i Komisionit, përpara të cilit u paraqit kërkesa, përbën shkelje të rëndë procedurale.
11. Nga shqyrtimi i akteve të administruara në proces, rezulton se në seancën dëgjimore të datës 02.07.2018 në Komision, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesë për përjashtimin nga shqyrtimi i çështjes të anëtares së trupit gjykues Brunilda Bekteshi, njëkohësisht edhe kryesuese e këtij trupi, bazuar në nenet 4, pika 6 dhe 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe neneve 72, pika 6 e 74, pika 3 e Kodit të Procedurës Civile. Kërkesën për përjashtimin e kryesueses, subjekti e ka paraqitur me pretendimin se fakti që znj. Bekteshi, në cilësinë e përfaqësueses së OSHEE-së, ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit Artan Lazaj nga gjykimi i çështjes civile me nr. 458 akti, datë regjistrimi 15.09.2015, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, provuar kjo me vendimin civil me nr. {***} akti, datë 12.05.2016, vendim i formës së prerë, përbën shkak serioz njëanshmërie dhe konflikti interesi për znj. Bekteshi.
12. Mospranimi i kërkesës së subjektit është vendosur nga i njëjti trup gjykues i Komisionit dhe procesverbali i diskutimeve, datë 02.07.2018, për shqyrtimin e kërkesës është nënshkruar nga të tre anëtarët e tij, përfshirë edhe kryesuesen ndaj së cilës është drejtuar kërkesa për përjashtim. Nga procesverbali i diskutimeve dhe nga arsyetimi i vendimit përfundimtar nr. 34, datë 11.07.2018, rezulton se trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenet 34 dhe 74 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në rregulloren e Komisionit, vendosi që ta prapësonte kërkesën e subjektit të rivlerësimit, duke mos qenë rasti për t’ia kaluar një tjetër trup gjykues për shqyrtim dhe vendimmarrje, pasi ajo rezultonte qartazi e vonuar e në mosrespektim të pikës 3 të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, si dhe e papranueshme, pasi nuk bazohej në fakte të reja.
13. Ligji nr. 84/2016, në nenin 27, pika 3 përcakton: “3. Çdo person, i cili ka informacion mbi ekzistencën e shkaqeve të konfliktit të interesit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, njofton

³ Në seancën gjyqësore publike, në Kolegj, të datës 23.01.2019

menjëherë me shkrim trupin gjykues, i cili ia përcjell kërkesën për vendim një trupi tjetër gjykues, të caktuar me short.” Bazuar në këtë përcaktim, vendimmarrja lidhur me kërkesën e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për përjashtimin e anëtares Bekteshi duhet të ishte shqyrtuar nga një trup tjetër gjykues, i përzgjedhur me short. Edhe rregullorja “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK)”, në nenin 20, pika 1 reflekton përcaktimin ligjor të sipërcituar duke shprehur: “1. Trupa gjykuese e njoftuar sipas nenit 15, me marrjen e kërkesës nga njëri prej anëtarëve të saj apo nga çdo person tjetër, sipas pikës 3 të këtij neni, njofton menjëherë kryetarin, i cili organizon procedurën e shortit për caktimin e trupës gjykuese që do të shqyrtojë kërkesën për përjashtimin ose jo të anëtarit nga procedura”. Trupi gjykues vlerëson se në analizimin e mundësisë së subjektit për të marrë dajeni mbi rrethanat e konfliktit të interesit të pretenduar dhe në vlerësimin se kërkesa e paraqitur prej tij në Gjykatën e Tiranës ishte e vonuar, trupi gjykues i Komisionit është shprehur mbi thelbin e kërkesës. Detyra e trupit gjykues duhet të kufizohet vetëm në atë sa i lejon urdhërimi ligjor, përcjelljen e kërkesës një trupi tjetër gjykues dhe jo shprehjen e saj në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore për shqyrtimin e kërkesës nga një trup tjetër gjykues. Trupi gjykues i Komisionit ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, të cilat në çdo rast urdhërojnë që kërkesa për përjashtim e komisionerit të shqyrtohet nga një trup gjykues tjetër, i caktuar me short. Shqyrtimi paraprakisht i kërkesës për përjashtim nga trupi gjykues të cilit i paraqitet kjo kërkesë nuk parashikohet, në asnjë rast, nga neni 27 i ligjit nr. 84/2016.

14. Edhe neni 75 i Kodit të Procedurës Civile, në paragrafin e parë përcakton: “Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve shqyrtohet në seancë nga një gjyqtar tjetër i së njëjtës gjykatë. Ndaj vendimit për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për përjashtim lejohet ankimi së bashku me vendimin përfundimtar”, duke sanksionuar kështu parimin se kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit shqyrtohet nga një trup tjetër gjykues. Në parashikimin e këtij neni mbi gjykatën kompetente për gjykimin e kërkesave të tilla nuk përcaktohet një filtrim paraprak i kërkesës nga trupi gjykues, para të cilit paraqitet kërkesa për përjashtim. Vlerësimi i papranueshmërisë së kërkesës për mosplotësimin e kriterëve formale të nenit 74 të Kodit të Procedurës Civile, apo rrëzimi pas vlerësimit në themel në kushtet e nenit 72 të këtij Kodi, është kompetencë e një tjetër trupi gjykues, të përzgjedhur me short.
15. Kërkesa për përjashtimin e një anëtarit të trupit gjykues lidhet drejtpërdrejt me parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme⁴. Gjykimi nga një gjykatë e paanshme është pjesë integrale e parimit të procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së. Në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese është shprehur se paanësia në kuptim të nenit 6, pika 1 e KEDNJ-së duhet të përcaktohet në përputhje me një test subjektiv, që nënkupton bindjen personale të gjyqtarit të veçantë për një çështje të caktuar, si dhe në përputhje me një test objektiv, i cili nënkupton të siguarit se gjyqtari ka ofruar garancitë e mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim⁵. Në vendimin nr. 11/2013, Gjykata Kushtetuese arsyeton: “Vlerësimi nga ana e vetë gjyqtarit të çështjes nëse ai është apo jo i paanshëm, nuk reflekton besim tek palët dhe si rrjedhim nuk garanton paanshmërinë e tij gjatë gjykimit. Si rrjedhim, palëve nuk u garantohet një dëgjim i drejtë mbi çështjen dhe për këtë arsye, procesi i rregullt ligjor është i cenuar në thelbin e tij.[...] Gjykata vlerëson se një zgjidhje e tillë ngre dyshime mbi paanshmërinë e gjyqtarit/trupit gjykues që në momentin e bërjes së kërkesës për përjashtimin e tij, pasi është e vështirë që palët të presin që vetë gjyqtari të vlerësojë nëse është ose jo i ndikuar nga faktorë objektivë ose subjektivë në gjykimin e çështjes. Me gjithë përpjekjet që mund të bëjë ai për të qenë objektiv,

⁴ Sipas vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe opinionit CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias, organet e rivlerësimit ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

⁵ Shih vendimin nr.21/2010 të Gjykatës Kushtetuese.

kjo gjë është e vështirë të reflektohet tek palët. Është pikërisht kjo mungesë e besimit tek palët që mund të çojë në krijimin e bindjes tek ta se nuk do të kenë një proces të rregullt ligjor, pasi gjyqtari nuk arrin ta përçojë këtë siguri. Gjykata rithekson se kur shqyrtohet një çështje e caktuar, ekziston një arsye legjitime për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm. Pikërisht, vendimin lidhur me faktin nëse dyshimi është apo jo i justifikueshëm, nuk mund ta marrë i njëjti gjyqtar kundër të cilit ngrihen pretendimet për paanshmëri.”

16. Rëndësinë e kalimit të testit objektiv, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ) e ka shprehur vazhdimisht në vendimet e saj, si një nga kushtet e procesit të rregullt ligjor. Në çështjen Mežnarić kundër Kroacisë, 2005, GJEDNJ është shprehur: “Gjykata vëren se procedurat kombëtare për sigurimin e paanshmërisë, përkatësisht rregullat që rregullojnë heqjen dorë të gjyqtarëve, janë faktor i rëndësishëm. Rregulla të tilla shprehin shqetësimin e legjislacionit kombëtar për të hequr të gjitha dyshimet e arsyeshme në lidhje me paanshinë e gjykatës ose gjykatës në fjalë dhe përbëjnë një përpjekje për të siguruar paanshinë, duke eliminuar shkaqet për shqetësime të tilla. Përveç sigurimit të mungesës së paragjyqimit konkret, ato janë të drejtuara në heqjen e çdo shfaqjeje të anshmërisë dhe kështu shërbejnë për të nxitur besimin që gjykatat duhet të frymëzojnë në publik, në një shoqëri demokratike. Prandaj, mosrespektimi i këtyre rregullave të njohura nga ligji kombëtar do të thotë që rasti është dëgjuar nga një gjykatë, paanshia e së cilës është e hapur ndaj dyshimit.[...] Në këtë aspekt edhe paraqitja merr rëndësi të caktuar ose, me fjalë të tjera, “drejtësia duhet jo vetëm të jepet, por edhe të duket se jepet”.
17. Duke vlerësuar respektimin e standardeve të mësipërme në çështjen konkrete në shqyrtim, trupi gjykues vlerëson se kërkesa e subjektit të rivlerësimit nuk u shqyrtua rregullisht sipas ligjit, nga një trup tjetër gjykues i Komisionit, duke e lënë paanshinë e trupit gjykues të hapur ndaj dyshimit, pasi vendimin lidhur me faktin nëse dyshimi është apo jo i justifikueshëm, nuk mund ta marrë i njëjti komisioner kundër të cilit ngrihen pretendimet për paanshmëri. Trupi gjykues i Komisionit duhet të kishte vënë në balancë parimin e ligjshmërisë me parimin e shpejtësisë në gjykim dhe të kishte vendosur në favor të zbatimit të drejtë të dispozitës procedurale, për të kryer një proces të rregullt ligjor. Kërkesa e subjektit të rivlerësimit nuk u shqyrtua rregullisht sipas ligjit nga një trup tjetër gjykues, duke krijuar një dyshim të justifikuar te subjekti i rivlerësimit, sipas të cilit atij nuk i është garantuar një dëgjim i drejtë dhe i paanshëm për çështjen e për pasojë vendimi përfundimtar nuk ka qenë produkt i një procesi të rregullt ligjor.
18. *Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit dhe çmon se vendimi nr. 34, datë 11.07.2018, i Komisionit është marrë në shkelje të neneve 42 dhe 179/b, pika 2 e Kushtetutës dhe nenit 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, neneve 4, pika 5 e 27 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 75 të Kodit të Procedurës Civile, duke cenuar parimin e procesit të rregullt ligjor dhe atë të gjyqimit nga një gjykatë e paanshme.*
Bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit është organi i vetëm gjyqësor që kryen kontrollin e vendimeve të Komisionit, mbi bazën e ankimit të subjektit të rivlerësimit ose Komisionerit Publik, duke garantuar në këtë mënyrë të drejtën themelore të subjekteve për akses në gjykatë, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së. Shkelja e rëndë procedurale e kryer nga trupi gjykues i Komisionit, hyn në rastet e parashikuara në nenet 53, shkronja “ç” dhe 54, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, si dhe në nenin 467 paragrafi i parë, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Civile, pasi vendimi i Komisionit nr. 34, datë 11.07.2018, është rrjedhojë e cenimit të parimit të paanshësisë, i lidhur ky edhe me përbërjen e trupit gjykues. Për këto arsye, trupi gjykues vendosi prishjen e vendimit nr. 34, datë 11.07.2018 të Komisionit.

19. Por kompetenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është përcaktuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton: “3. Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t’ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë bazohet tek kriteret e përcaktuara në këtë ligj.”
- Sipas këtij parashikimi kushtetues, Kolegji nuk mund t’ia kthejë Komisionit çështjen për rishqyrtim në rastet kur kontrollon një vendim përfundimtar të Komisionit. Kolegji, pavarësisht se e gjeti vendimin nr. 34, datë 11.07.2018, të Komisionit të marrë në shkelje të rëndë procedurale dhe e prishi atë, nuk mund ta kthente për rishqyrtim në Komision çështjen e rivlerësimit të subjektit Artan Lazaj, por kreu vetë rivlerësimin e tij, që nga momenti i konstatimit të kësaj shkeljeje, gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore në Komision, ashtu siç edhe vetë subjekti i rivlerësimit theksoi në seancën gjyqësore publike të zhvilluar në Kolegj.
20. Bashkëlidhur ankimit kundër vendimit nr. 34, datë 11.07.2018, të Komisionit, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti prova të reja.
21. Bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi. Gjatë shqyrtimit të ankimit në seancë gjyqësore publike, subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte pretendime shtesë përtej shkaqeve të ankimit, lidhur me faktet dhe mënyrën e zbatimit të ligjit dhe as nuk paraqiti prova të reja.
22. Trupi gjykues i Kolegjit, për shqyrtimin e ankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, administroi në seancë gjyqësore publike gjithë materialin procedues të akteve të administruara në fashikullin gjyqësor që Komisioni ka depozituar pranë Kolegjit me nr. {***} prot., datë 11.09.2018, të Komisionit dhe nr. {***} prot., datë 11.09.2018, të Kolegjit, si dhe çdo akt tjetër që është analizuar në vendimin nr. 34, datë 11.07.2018, të Komisionit, që nuk u kundërshtuan nga subjekti i rivlerësimit.
23. Në konkluzionet përfundimtare⁶, subjekti i rivlerësimit parashtrroi disa shkaqe të reja, përtej atyre të parashtruara në ankimin e depozituar, në kundërshtim me sa kishte deklaruar gjatë hetimit gjyqësor, se nuk kishte pretendime të tjera veç atyre të paraqitura në ankim.
- Bazuar në nenin 179/b, pikat 2 e 5, në nenin F, pikat 1 e 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 302, 459 dhe 465, pika 4 e Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se e shqyrton çështjen, duke marrë në analizë vetëm shkaqet që ka parashtruar subjekti i rivlerësimit në ankim, dhe jo shkaqet e reja të parashtruara në konkluzionet përfundimtare, pasi kishte përfunduar hetimi gjyqësor.
24. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vlerësimi përfundimtar i Komisionit, bazuar vetëm në hetimin e një kriteri, përbën një shkelje të rëndë të nenit Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe të nenit 6 të KEDNJ-së.* Trupi gjykues i Kolegjit arsyeton se dispozita që rregullon këtë vendimmarrje të Komisionit ose të Kolegjit, është neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, e cila përcakton: “2. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurave.”
25. Në mbështetje të këtij parashikimi ligjor, Komisioni me vendimin nr. 01, datë 14.12.2017, ka vendosur fillimin e hetimit administrativ të subjektit për të tria kriteret e vlerësimit. Pasi ka vlerësuar se e ka hetuar në mënyrë të plotë kriterin e pasurisë, bazuar në provat e mbledhura

⁶ Në seancën gjyqësore publike, në Kolegj, të datës 28.01.2019.

dhe vlerën e tyre provuese, me vendimin nr. 02, datë 06.06.2018, trupi gjykues, bazuar në relacionin e përgatitur nga relatori i çështjes dhe me kërkesën e tij, ka vendosur ta përfundojë hetimin kryesisht, vetëm për kriterin e pasurisë, pa qenë nevoja e përfundimit të hetimit të plotë edhe të dy kriterëve të tjera, pasi janë plotësuar kushtet e parashikuara nga neni 52 i ligjit nr. 84/2016 dhe provat kanë arritur nivelin e provueshmërisë. Neni 4 i ligjit nr. 84/2016, por edhe nenet e tjera të tij, nuk parashikojnë urdhërime ndaluese që të pengojnë kryerjen e procesit të rivlerësimit të subjektit dhe disponimin e organeve të rivlerësimit në lidhje me të, bazuar vetëm në një kriter. Por procesi i rivlerësimit nuk konsiderohet si një gjë e gjykuar për kriteret e pashqyrtuara, nëse një vendim i Kolegjit shfuqizon vendimmarrjen e Komisionit, mbështetur vetëm në një ose dy kriterë.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, vendimmarrjen e Komisionit për përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar vetëm në kriterin e kontrollit të pasurisë, mbështetur edhe në një qëndrim tashmë të mbajtur edhe në çështje të tjera të ngjashme të shqyrtuara prej Kolegjit, e konsideron një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

26. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se gjatë procesit të rivlerësimit, ndryshe nga sa parashikon neni 52 i ligjit nr. 84/2016, provat apo të dhënat e paraqitura prej tij nuk janë vlerësuar dhe analizuar nga Komisioni, sepse në seancë dëgjimore u prezantuan prej relatorit rezultatet e hetimit paraprak, me të cilat subjekti ishte njohur tashmë.* Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nga aktet e fashikullit gjyqësor rezulton se në fillim të seancës dëgjimore në Komision, më datë 02.07.2018, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesë për njohjen me analizën e Komisionit mbi provat e paraqitura prej tij, pas përfundimit të hetimit administrativ. Kjo kërkesë është rrëzuar nga trupi gjykues, me arsyetimin se subjektit të rivlerësimit i janë bërë të njohura rezultatet e hetimit. Ai ka paraqitur provat dhe shpjegimet mbi këto gjetje, është njoftuar për datën e seancës dëgjimore dhe mundësinë e paraqitjes së provave të reja dhe të së drejtës për të dhënë shpjegime, të cilat në tërësinë e tyre janë vlerësuar në vendimmarrjen e trupit gjykues. Nga aktet e administruara, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegime dhe prova bashkëlidhur tyre, gjatë gjithë procesit të rivlerësimit. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, rezultatet e hetimit administrativ përmbajnë gjetjet e trupit gjykues në lidhje me kriterin përkatës të rivlerësimit, pasi ai ka arritur në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera, për të provuar të kundërtën. Në rezultatet e hetimit administrativ, trupi gjykues për çdo gjetje është shprehur qartë se në cilat prova është bazuar, duke i cituar dhe analizuar ato. Pas njohjes me dosjen dhe rezultatet e hetimit, subjekti ka paraqitur shpjegimet dhe provat që ai i ka konsideruar të nevojshme. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, relatori i çështjes, në kundërshtim me sa pretendon subjekti, ka bërë një përmbledhje të dosjes së procesit të rivlerësimit, si dhe të hapave proceduralë hetimorë të ndërmarrë, me qëllim realizimin e një debati real ndërmjet subjektit dhe trupit gjykues. Në këtë kuptim, shprehja e analizës përfundimtare të provave pa u administruar prova të reja të mundshme të paraqitura prej subjektit në seancë dëgjimore, pa u dëgjuar shpjegimet përfundimtare të tij, si dhe pa u vlerësuar ato në raport me rrethanat e tjera faktike dhe ligjore, do të përbënte shkelje të nenit 57, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon elementet e pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit të Komisionit, ndër të tjera rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues, si dhe provat dhe arsyet mbi të cilat mbështetet vendimmarrja. Njoftimi i subjektit për rezultatet e hetimit administrativ është momenti procedural, kur ai njihet me tërësinë e provave të mbledhura, analizën e tyre, rezultatet e pritshme, për t'i kundërshtuar më pas, në funksion të barrës për të provuar të kundërtën. Në ankim dhe në konkluzionet përfundimtare në seancë gjyqësore në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar drejtpërdrejt rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, duke pranuar kështu se rezultatet e hetimit përmbajnë analizën e provave të

vlerësuara nga Komisioni. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

27. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se shpallja e vendimit përfundimtar të Komisionit, 9 ditë pas zhvillimit të seancës dëgjimore, është bërë në shkelje të afateve procedurale të parashikuara në nenin 55, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore, maksimalisht 5 ditë, sipas Kodit të Procedurave Administrative.* Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se seanca dëgjimore në Komision është zhvilluar në datat 28.06.2018, 02.07.2018 dhe 11.07.2018. Në përfundim të saj, më datë 11.07.2018, Komisioni ka shpallur vendimin. Trupi gjykues i Kolegjit arsyeton se ligji nr. 84/2016, në nenin 55, pika 6 përcakton se vendimi i Komisionit shpallet në fund të seancës dëgjimore, ndërsa në pikën 7 përcakton se vendimi me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore. Këto janë të vetmet afate ligjore, të cilat lidhen me shpalljen dhe njoftimin e vendimit të Komisionit të përcaktuar nga ligji nr. 84/2016, i cili është ligji i posaçëm për organizimin, metodologjinë, procedurat dhe standardet e procesit të rivlerësimit. Ligjvënësi në këtë nen nuk ka bërë asnjë referencë ligjore të ndonjë nen i Kodit të Procedurave Administrative apo i ndonjë ligji tjetër, teknikë që e ka përdorur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, në rastet kur ka pasur qëllim zbatimin e dispozitave të caktuara, nga ligje të tjera. E megjithatë, në Kodin e Procedurave Administrative nuk ka një afat 5-ditor të përcaktuar, për shpalljen e vendimit në përfundim të procedurës administrative, siç pretendon subjekti. Por, edhe nëse do të kishte një afat të tillë, në mungesë të një reference të kjo normë, përparësi merr norma e ligjit të posaçëm, pasi ajo ka prioritet mbi ligjin e përgjithshëm. Në raportin ndërmjet Kodit të Procedurës Administrative dhe ligjit nr. 84/2016, ky i fundit sanksionon në mënyrë specifike rregullat e procesit të rivlerësimit dhe si i tillë konsiderohet normë specifike, sipas parimit të së drejtës *lex specialis derogat generali*. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vendimi i Komisionit nuk është shpallur në shkelje të nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, për pasojë pretendimi i subjektit është i pabazuar.

Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kriterin e pasurisë dhe shkaqet e ankimit lidhur me të

28. Trupi gjykues vlerësoi kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit, bazuar në provat e administruara, të cilat janë grumbulluar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe nuk janë kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit, duke marrë në analizë: provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit; raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja dhe deklaratat periodike të pasurisë së subjektit; provat shkresore të administruara nga organet publike dhe private; deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik me Komisionin; shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, si dhe në shkaqet e ankimit të paraqitura prej tij në Kolegj, për këtë kriter. Subjekti i rivlerësimit në ankim, si dhe në shpjegimet në seancë gjyqësore, ka kundërshtuar gjetjet e konstatuara nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ, në lidhje me pasuritë e paluajtshme e të luajtshme, të deklaruara prej tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe në deklaratimet periodike të pasurisë në vitet 2003-2016.
29. **Për pasurinë e deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, apartament banimi me sipërfaqe 158,1 m², sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.11.2010, me vlerë 129.000 euro, me pjesë takuese ¼ e banesës, me adresë: Rruga {***}, pallati {***}, hyrja {***}, apartamenti {***}, Njësia nr. {***}, Tiranë, në përfundim të hetimit kryesisht të Komisionit, ka rezultuar se:**
- nuk është deklaruar kjo pasuri në deklaratën periodike të vitit 2010, por është deklaruar vetëm në vitin 2011;

- në deklaratën e vitit 2011 çmimi i blerjes së këtij apartamenti është deklaruar në vlerën 120.000 euro dhe pjesa takuese 100%, ndërsa në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit është deklaruar në vlerën 129.000 euro dhe pjesa takuese ¼;
- në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie;
- në deklaratën periodike të vitit 2009 nuk është deklaruar likuidimi i detyrimit prej 3.900.000 lekësh në favor të {***} SHPK;
- ka mospërputhje mes deklaratës së {***} SHPK të datës 21.03.2018 dhe deklaratave periodike të pasurisë së subjektit;
- nuk rezultojnë të provuara dhe as të deklaruara ndër vite në deklaratat periodike dhe as nga dokumentet bankare, pagesat e pretenduara se janë kryer me këste deri në vitin 2014;
- ka mospërputhje midis deklaratave periodike dhe dokumenteve bankare;
- nuk është deklaruar dhe nuk është provuar momenti i parë i posedimit, prejardhja dhe kryesisht burimi i ligjshëm i shumës prej 50.000 eurosh;
- nuk është deklaruar posedimi i shumës 50.000 euro më 31.12.2009;
- nuk është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2010 dhe as në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit pagesa/shpenzimi i shumës 50.000 euro, kryer në favor të {***} SHPK;
- nuk janë deklaruar të ardhura nga emigracioni;
- pagesat e kryera në favor të {***} SHPK bien ndesh me deklaratimet noteriale të bëra në kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.11.2010, si dhe ka mospërputhje midis tyre dhe deklaratës së {***} SHPK të datës 21.03.2018.

30. *Për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se apartamentin me sipërfaqe 158,1 m² nuk e ka deklaruar në vitin 2010 për arsye të harresës, se vlera 120.000 euro e deklaruar në vitin 2011 përfaqëson vlerën e rënë dakord fillimisht me shoqërinë {***} SHPK, ndërsa më vonë kanë rënë dakord që kjo shoqëri të kryente dhe mobilimin e apartamentit duke çuar në vlerën përfundimtare prej 129.000 eurosh, sa është deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe se në vitin 2011 ka deklaruar pjesën takuese 100% të këtij apartamenti, ndërsa në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit ka deklaruar 25%, sepse familja e tij përbëhet nga katër anëtarë, me të cilët ai ndan në mënyrë të barabartë çdo pasuri të paluajtshme e të luajtshme. Trupi gjyqësor i Kolegjit konstaton sa më poshtë.*

31. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie. Në lidhje me këtë mosdeklarim, subjekti nuk ka dhënë shpjegime konkrete të drejtpërdrejta në asnjë fazë të procesit të rivlerësimit dhe as në ankim.

Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.11.2010, me palë porositëse Artan Lazaj dhe sipërmarrës shoqëria {***} SHPK. Sipas paragrafit IV të kësaj kontrate, vlera e apartamentit është 129.000 euro, ndërsa sipas paragrafit V shuma prej 79.000 eurosh është shlyer jashtë zyrës noteriale, ndërsa pjesa tjetër prej 50.000 eurosh do të shlyhej brenda janarit 2011.

Në deklaratën periodike të pasurisë 2010, subjekti nuk ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes për apartamentin, e lidhur më datë 19.11.2010 dhe as detyrimin e shlyer prej 79.000 eurosh në bazë të kësaj kontrate, e për rrjedhojë as burimin e krijimit të të ardhurave për pagimin e këtij detyrimi.

Në deklaratën periodike të pasurisë 2011, subjekti deklaroi kontratën e sipërmarrjes për blerjen e apartamentit në Tiranë, Rruga {***}, me burim krijimi shitjen e një apartamenti në pronësinë e tij i deklaruar në deklaratimet e mëparshme, kredinë e marrë në Raiffeisen Bank në shumën 4.000.000 lekë të deklaruar më parë, si dhe kursimet nga pagat. Shuma e paguar është 120.000 euro dhe pjesa takuese 100%. Vlera e apartamentit në këtë deklaratim nuk përputhet me vlerën e cituar në kontratën e sipërmarrjes, ndërsa pjesët takuese nuk përputhen me ato të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

Subjekti në shpjegimet e tij pretendon se mosdeklarimi në vitin 2010 ka ndodhur për shkak të harresës, por apartamentin e ka deklaruar në vitin 2011, pasi ky është viti kur ai ka filluar të banojë aty, ndërsa vlera e deklaruar në vitin 2011, megjithëse është vlera e rënë dakord fillimisht me sipërmarrësin, është një lapsus i tij në deklaratim. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti nuk është bindës në këtë pretendim të tij për harresë e lapsus në mosdeklarimin e kësaj pasurie, në një kohë kur ky apartament ishte e vetmja pasuri që ai dispononte në vitin 2010 dhe ai kishte paguar një vlerë të konsiderueshme të detyrimit kontraktor sipas kontratës së sipërmarrjes.

Në lidhje me deklaratimin e pjesës takuese të apartamentit në ¼ në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti shpjegon se e ka deklaruar të tillë, pasi ata janë katër pjesëtarë në familje (bashkëshortët dhe dy fëmijët) dhe gjithçka e ndajnë në mënyrë të barabartë. Subjekti apartamentin 158,1 m² e disponon, sipas kontratës së sipërmarrjes dhe rezulton se kjo pasuri nuk është e regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë.⁷ Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se formulari i deklaratimit të pasurisë së rivlerësimit - shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016, kërkon deklaratimin e të drejtave reale mbi pasurinë, për pasojë deklaratimin e pjesëve zotëruese dhe jo pjesëve hipotetike të pasurisë së subjektit deklarues.

32. Në vlerësim të konstatimeve sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti ka kryer deklaratim të pamjaftueshëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit për pjesët takuese dhe për mosdeklarimin e burimit të krijimit të këtij apartamenti, si dhe deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2010 për mosdeklarim të të drejtave reale që rridhnin nga kontrata e sipërmarrjes për apartamentin, ndërsa në deklaratën e vitit 2011 deklarim të pasaktë për vlerën e blerjes së tij, bazuar në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
33. *Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se ka mungesë burimesh për të blerë pasurinë apartament 158,1 m², duke pretenduar se ai është blerë nga një kredi e përfituruar nga Raiffeisen Bank në shumën 29.000 euro, shumë e kaluar te shoqëria {***} SHPK, si dhe nga një pjesë e vlerës së shitjes së një apartamenti në pronësi të tij në Rrugën e {***}, me sipërfaqe 120 m², në shumën 50.000 euro, pagesë e kryer nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare (në vijim BKT) në llogarinë e shoqërisë {***} SHPK, ndërsa pjesa tjetër e mbetur e detyrimit të paguar prej 50.000 eurosh⁸ përbëhej nga kursimet prej pagave dhe shuma prej 2.040.000 lekësh, cila ishte pjesë e të ardhurave të përfituara po nga shitja e apartamentit në Rrugën e {***}. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se gjatë procesit të hetimit administrativ, në përgjigjet që subjekti u kthen më datë 24.03.2018 pyetjeve të Komisionit, ka deklaruar se*

⁷ Nga informacioni i dërguar në Komision nga ZVRPP Tiranë, me shkresë nr. {***} prot., datë 23.01.2008, rezulton se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të nuk figurojnë pasuri të regjistruara.

⁸ Subjekti pretendon se ka paguar: 29.000 euro + 50.000 euro + 50.000 euro = 129.000 euro.

në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes së apartamentit 158,1 m² janë likuiduar vlerat prej 3.900.000 lekësh dhe prej 50.000 eurosh, nëpërmjet pagesës në bankat e nivelit të dytë, ndërsa vlera e mbetur është likuiduar me këste deri në vitin 2014, sipas deklaratës së datës 21.03.2018, të lëshuar nga shoqëria {***} SHPK. Në deklaratën e datës 21.03.2018, shoqëria {***} SHPK ka deklaruar se detyrimi i lindur nga kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.11.2010, e lidhur ndërmjet saj dhe z. Artan Lazaj, në vlerën prej 129.000 eurosh, është likuiduar plotësisht. Mënyra e likuidimit është kryer si më poshtë: “Vlera prej 3.900.000 lekësh dhe vlera prej 50.000 eurosh janë likuiduar nëpërmjet pagesës në bankat e nivelit të dytë. Vlera e mbetur është likuiduar me këste deri në vitin 2014, për të cilat na mungon evidenca pasi arshiva e shoqërisë nuk është më e disponueshme”.

34. Për të provuar shlyerjen e njërit prej këtyre detyrimeve, subjekti ka paraqitur urdhërxhirim të Bankës Raiffeisen “Kërkesë për transferim fondesh”, datë 17.08.2009, me urdhërues Artan S. Lazaj dhe përfitues {***} SHPK, për vlerën 3.900.000 lekë, me përshkrim “Likuidim detyrimi”. Kryerja e kësaj transferte konfirmohet edhe nga Raiffeisen Bank⁹. Rezulton se pagesa prej 3.900.000 lekësh është kryer rreth një vit më parë nga data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes. Në deklaratën periodike të vitit 2009, subjekti ka deklaruar kredinë në Raiffeisen Bank në vlerën 4.000.000 lekë, por nuk ka deklaruar kalimin e saj në vlerën 3.900.000 lekë, si shlyerje detyrimi në favor të {***} SHPK.
- Për kryerjen e pagesës së dytë, siç provohet nga informacioni i përcjellë në Komision nga Banka Kombëtare Tregtare¹⁰ (në vijim BKT), Artan Lazaj ka depozituar *cash* në valutë shumë 50.000 euro për llogari të {***} SHPK, më datë 18.08.2010, me përshkrimin “Likuidim pjesor apartamenti”. Rezulton se edhe pagesa prej 50.000 eurosh është kryer para datës së lidhjes së kontratës së sipërmarrjes. Në deklaratën periodike 2010, subjekti nuk ka deklaruar shlyerjen e detyrimit prej 50.000 eurosh, në favor të shoqërisë {***} SHPK.
35. Vlerën e mbetur prej 50.000 eurosh, subjekti i mbështetur edhe nga deklarata e datës 21.03.2018 e {***} SHPK, pretendon se e ka paguar me këste deri në vitin 2014, por nuk ka provuar me asnjë lloj prove mënyrën e pagimit të këtyre kësteve në rrugë bankare apo *cash*, vlerën e çdo kësti dhe kohën e pagimit të tij. Ky pretendim i subjektit bie në kundërshtim edhe me sa ka deklaruar ai vetë në deklaratën periodike të vitit 2011, sipas së cilës ka paguar tërësisht vlerën e këtij apartamenti. Gjithashtu, në deklaratat periodike nga viti 2011 deri në vitin 2014, subjekti nuk ka deklaruar në rubrikat përkatëse pagim detyrimi apo shpenzime të kryera për blerjen e apartamentit 158,1 m², siç pretendohet bazuar në deklaratën e {***} SHPK.
- Në kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.11.2010, palët Artan Lazaj dhe {***} SHPK kanë deklaruar se për pagesën e apartamentit 158,1 m² shuma prej 79.000 eurosh është shlyer jashtë zyrës noteriale, ndërsa pjesa tjetër prej 50.000 eurosh do të shlyhej brenda janarit 2011.
36. Në analizë të provave të administruara dhe duke u mbështetur në parashikimin e nenit 690 të Kodit Civil, i cili përcakton: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”, i lidhur me nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton: “Aktet zyrtare

⁹ Informacion i përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 12.01.2018.

¹⁰ Me shkresën nr. {***} prot., datë 16.03.2018.

që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”, trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti deri në vitin 2011 ka shlyer tërësisht detyrimin kontraktor prej 129.000 eurosh për blerjen e apartamentit 158,1 m².

37. Për sa i përket burimit të krijimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie, subjekti në ankim pretendon se shuma prej 3.900.000 lekësh, e shlyer më datë 17.08.2009, buron nga kredia e marrë në Raiffeisen Bank, ndërsa pagesa e dytë në shumën prej 50.000 eurosh, e shlyer më datë 18.08.2010, buron nga një pjesë e fitimit të shitjes së apartamentit në pronësi të tij në Rrugën {***}, i shitur përfundimisht në vitin 2010. Pjesa e mbetur prej 50.000 eurosh buron prej kursimeve nga pagat dhe nga një pjesë e fitimit rreth 2.040.000 lekësh të kursyera, si pjesë e mbetur e të ardhurave nga shitja e të njëjtit apartament në Rrugën {***}.
- Subjekti, shitjen e apartamentit në Rrugën {***} e ka deklaruar vetëm një herë, në deklaratën periodike të vitit 2008: “Shitur apartamenti me sipërfaqe 120 m² në Tiranë, në shumën 90.000 euro, deklaruar më parë, nga e cila zbritet taksa e shitjes 5.000 euro. Vlera: 85.000 euro”. Më poshtë, në të njëjtin formular deklaroi: “Nga shuma e mësipërme është shlyer kredia në Alpha Bank, në shumën 2.508.000 lekë dhe është blerë një autoveturë në vlerën 500.000 lekë. Gjendje *cash* në vlerën 60.000 euro”, ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2010 nuk deklaroi përfitim të ardhurash nga shitja e apartamentit në Rrugën {***}, as kryerjen e pagesës prej 50.000 eurosh në favor të {***} SHPK.
38. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se subjekti ka lidhur me Raiffeisen Bank, dega Gjirokastrë, “Kontratë Kredie Bankare dhe Hipoteke”, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.06.2009, sipas së cilës kjo bankë ka financuar subjektin në shumën 4.170.000 lekë, për 180 muaj me “kredi konsumatore”. Nga verifikimi i lëvizjeve në llogarinë e subjektit në Bankën Raiffeisen, rezulton që kredia më sipër të jetë disbursuar më 27.07.2009 dhe më 17.08.2009 është transferuar shuma 3.903.500 lekë, me përshkrimin “Për likuidim detyrimi”, përfituesi {***} SHPK. Trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të drejtë pretendimin e subjektit, se detyrimi prej 3.900.000 lekësh ndaj shoqërisë {***} SHPK është paguar me kredinë e financuar nga Raiffeisen Bank.
39. Për të vlerësuar mundësinë e subjektit për të paguar vlerën e mbetur prej 100.000 eurosh të detyrimit për apartamentin 158,1 m², është kryer analiza financiare për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011, pra nga viti kur është kryer shitja e apartamentit me sipërfaqe 120 m² në Rrugën {***}, të ardhurat e së cilës subjekti pretendon se i ka përdorur si burim krijimi për pasurinë objekt vlerësimi, deri më janar 2011, viti kur është shlyer tërësisht vlera e kontratës së sipërmarrjes prej 129.000 eurosh. Me qëllim shqyrtimin sa më të drejtë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, analiza financiare është kryer për të vlerësuar nëse të ardhurat e ligjshme të realizuara nga subjekti, në secilin prej këtyre viteve, kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar pagesën prej 50.000 eurosh më datë 18.08.2010 dhe pagesën prej 50.000 eurosh në fund të janarit 2011 për blerjen e apartamentit 158,1 m², blerjet e pasurive të luajtshme, realizimin e kursimeve, pra gjendjen e likuiditeteve në bankë sipas dokumentacionit bankar

dhe *cash* në shtëpi sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat e pasurisë ndër vite, si dhe kryerjen e shpenzimeve jetike dhe atyre të deklaruara.

40. Në analizën financiare janë konsideruar të ardhurat e ligjshme nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes së tij, siç janë vërtetuar nga institucionet publike ku ata kanë ushtruar detyrën përkatëse.

Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike vjetore 2007-2010 ka deklaruar të ardhura nga paga e bashkëshortes si menaxhere e entit turistik {***}, Gjirokastër, në këto vlera: për vitin 2007 në vlerën 720.000 lekë, në vitet 2008 deri 2010 ka deklaruar 600.000 lekë për çdo vit. Këto të ardhura të bashkëshortes nuk janë deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se bashkëshortja e tij ka qenë në marrëdhënie pune pranë kompleksit turistik {***}, Gjirokastër duke paraqitur si dokumentacion justifikues vetëm vërtetimin e administratores së këtij kompleksi, datë 13.06.2018, sipas të cilit: “[...] Znj. A. M. Lazaj ka punuar pranë kompleksit {***} me detyrë menaxhere e guidave turistike. Paga neto e përfituar gjatë periudhës 1 janar 2009 deri më datë 31 dhjetor 2009 është 800.000 lekë.” Ky vërtetim jep të dhëna vetëm për të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit për vitin 2009, por jo për vitet 2007, 2008, 2010.

Bazuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, duhet të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument justifikues, që të vërtetojë marrëdhënien e punës së bashkëshortes së tij në kompleksin {***}, Gjirokastër, për vitet 2007, 2008, 2009 dhe 2010, si kontratë pune ose listëpagesa të punëdhënësit, dhe as vërtetime bankare apo dokumentacion tjetër provues për kalimin e pagës. Edhe në vërtetimin e lëshuar nga administratorja e kompleksit turistik, nuk jepen të dhëna për ekzistencën e një kontrate punësimi. Gjithashtu, nga verifikimi i llogarive bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, rezulton se kompleksi {***}, Gjirokastër nuk ka derdhur asnjë shumë në favor të znj. A. Lazaj, në asnjë nga vitet e deklaruara nga subjekti. Subjekti nuk ka vërtetuar marrjen e pagave të pretenduara dhe se si janë paguar detyrimet tatimore për këto të ardhura të pretenduara, sipas legjislacionit në fuqi. Një informacion i tillë nuk jepet as nga kompleksi turistik, i cili pretendohet se ka kryer pagesat përkatëse ndër vite. Për rrjedhojë, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se këto të ardhura nuk konsiderohen të ligjshme, për pasojë nuk i ka konsideruar ato në analizën financiare.

41. Element tjetër përbërës i analizës financiare janë shpenzimet e kryera nga familja Lazaj gjatë periudhës në vlerësim. Në ankim, subjekti ka kundërshtuar përlllogaritjet e kryera nga Komisioni për sa u përket shpenzimeve për konsum familjar ose shpenzimeve jetike, të cilat janë pasqyruar në rezultatet e hetimit administrativ si shuma fikse prej 692.308 lekësh, për çdo vit. Bazuar në këtë pretendim të subjektit, si dhe për të zgjidhur sa më drejt çështjen, për përlllogaritjen e shpenzimeve familjare, trupi gjykues u është referuar të dhënave zyrtare “Shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së njësisë ekonomike familjare” publikuar nga INSTAT¹¹. Në shpenzimet familjare janë përlllogaritur edhe shpenzimet minimale të

¹¹ <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes/#tab2>

udhëtimeve private të kryera nga familja Lazaj jashtë vendit, sipas deklarimeve të vetë subjektit dhe raporteve të sistemit TIMS (pa përfshirë udhëtimet, për të cilat subjekti provoi me dokumentacion se janë përballuar nga të tretët), si dhe shpenzime për interesa kredie.

42. Më tej, në analizën financiare janë konsideruar: ndryshimi i pasurisë së subjektit duke përfshirë këtu shtimin e pasurisë së paluajtshme e të luajtshme, si dhe shtimin e likuiditeteve në bankë, sipas dokumentacionit të përcjellë nga institucionet bankare përkatëse e likuiditeteve *cash* në banesë, sipas deklarimeve në deklaratimet periodike të pasurisë në vite. Në zërin “detyrime” janë përfshirë shlyerjet e kredive përkatëse të vërtetuara edhe nga dokumentacioni i përcjellë nga institucionet bankare, si dhe pagesat e kryera ndaj shoqërisë {***} SHPK për likuidimin e apartamentit 158,1 m².

Për efekt të konvertimit të të dhënave nga monedha e huaj në atë vendase, është përdorur si referencë “arkiva e kurseve të këmbimit”, publikuar në faqen zyrtare në internet të Bankës së Shqipërisë¹², në varësi të periudhës përkatëse.

43. Të dhënat e analizës financiare për vitin 2008 janë: a) të ardhurat e ligjshme në vlerën totale 12414.629 lekë; b) shpenzimet e njohura të familjes Lazaj të përlllogaritura në vlerën totale 1942.044 lekë, ku përfshihen: i) shpenzime për konsum në vlerën 910.936 lekë; ii) shpenzimet e udhëtimeve private në vlerën 357.229 lekë; iii) interesa për kredinë në Alpha Bank në vlerën 57.967 lekë; iv) tatim mbi të ardhurat nga shitja e apartamentit 120 m² në vlerën 615.912 lekë; c) ndryshimi i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në vlerën totale 9.405.454 lekë, ku përfshihen: i) blerje autoveture 500.000 lekë; ii) shtesë në likuiditete në vlerën totale 8.905.454 lekë (përfshirë *cash* 60.000 euro nga shitja e apartamentit 120 m²); d) detyrime në vlerën totale -2.506.770 lekë, sipas kontratës së kredisë me Alpha Bank.

Në përfundim të analizës së të dhënave të pasqyruara si më sipër, rezulton se subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme krijimin e pasurive dhe shpenzimet e kryera për vitin 2008 në vlerën 1.439.639 lekë.

44. Të dhënat e analizës financiare për vitin 2009 janë: a) të ardhurat e ligjshme në vlerën totale 3.238.515 lekë; b) shpenzimet e njohura të familjes Lazaj të përlllogaritura në vlerën totale 1.238.086 lekë, ku përfshihen: i) shpenzime për konsum në vlerën 899.832 lekë; ii) shpenzimet e udhëtimeve private në vlerën 166.662 lekë; iii) interesa për kredinë në Raiffeisen Bank në vlerën 171.592 lekë; c) ndryshimi i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në vlerën totale 6.499.719 lekë, ku përfshihen: i) shlyerje e detyrimit ndaj {***} SHPK, në vlerën 3.903.500 lekë; ii) shtesë në likuiditete në vlerën totale 2.596.219 lekë; d) detyrime në vlerën totale 3.876.990 lekë, ku përfshihen: i) hua në Raiffeisen Bank në vlerën 4.170.000 lekë; ii) detyrim për kredinë në Raiffeisen Bank në vlerën -293.010 lekë.

Në përfundim të analizës së të dhënave të pasqyruara si më sipër, rezulton se subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme krijimin e pasurive dhe shpenzimet e kryera për vitin 2009, në vlerën 622.301 lekë.

45. Të dhënat e analizës financiare për vitin 2010 janë: a) të ardhurat e ligjshme në vlerën totale 2.339.692 lekë; b) shpenzimet e njohura të familjes Lazaj të përlllogaritura në vlerën totale 1.502.626 lekë, ku përfshihen: i) shpenzime për konsum në vlerën 922.199 lekë; ii) shpenzimet e udhëtimeve private në vlerën 99.790 lekë; iii) interesa për kredinë në Raiffeisen Bank në vlerën 480.637 lekë; c) ndryshimi i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në vlerën totale 8.867.730 lekë, ku përfshihen: i) blerje autoveture në vlerën 125.000 lekë; ii) shtesë në

¹² https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/

likuiditete në vlerën totale 1853.230 lekë; iii) reduktim i kursimeve për shlyerjen e detyrimit ndaj {***} SHPK në vlerën 6889.500 lekë; d) detyrime në vlerën totale 6776.685 lekë, ku përfshihen: i) shlyerje e detyrimit ndaj {***} SHPK, në datë 18.08.2010 në vlerën 6889.500 lekë; ii) detyrim për kredinë në Raiffeisen Bank në vlerën -112.815 lekë.

Në përfundim të analizës së të dhënave të pasqyruara më sipër, rezulton se subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme krijimin e pasurive dhe shpenzimet e kryera për vitin 2010, në vlerën 1253.979 lekë. Nëse kjo analizë do të kryhej, duke konsideruar secilin prej elementeve të saj, në vlerat përkatëse deri më datë 18.08.2010, datë kur është shlyer detyrimi prej 50.000 eurosh në favor të {***} SHPK, atëherë subjekti nuk do të justifikonte krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve deri në këtë datë, në vlerën 202.618 lekë.

46. Bazuar në rezultatet e analizës financiare për çdo vit si më sipër, të cilat pasqyrojnë vlera negative të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar rritjen e pasurisë dhe kryerjen e shpenzimeve nga janari 2008 deri në dhjetor të vitit 2010, rezulton se subjekti nuk mund të paguante detyrimin prej 50.000 eurosh ndaj {***} SHPK në janar të vitit 2011. Nga kryerja e analizës financiare për gjithë vitin 2011, duke konsideruar kryerjen e pagesës prej 50.000 eurosh në favor të {***} SHPK, të dhënat janë: a) të ardhurat e ligjshme në vlerën totale 1928477 lekë; b) shpenzimet e njohura të familjes Lazaj të përlllogaritura në vlerën totale 1407964 lekë, ku përfshihen: i) shpenzimet për konsum në vlerën 922.199 lekë; ii) shpenzimet e udhëtimeve private në vlerën 41.979 lekë; iii) interesat për kredinë në Raiffeisen Bank në vlerën 443.786 lekë; c) ndryshimi i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në vlerën totale 7.588.799 lekë, ku përfshihen: i) shtesë në likuiditete në vlerën totale 647.008 lekë; ii) shlyerje e detyrimit ndaj {***} SHPK në vlerën 6941.791 lekë; d) detyrime në vlerën totale -134.228 lekë, ku përfshihen: i) shlyerje e kredisë në Raiffeisen Bank në vlerën -134.228 lekë. Në përfundim, rezulton se subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme krijimin e pasurive dhe shpenzimet e kryera për vitin 2011, në vlerën 7.202.514 lekë.

Trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për justifikimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 158,1 m², bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

47. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se hetimi dhe gjykimi i Komisionit kanë qenë paragjykses, pasi citimin e burimit të të ardhurave “Nga emigracioni” në dokumentacionin bankar të pagesës së bërë në BKT, prej tij në favor të {***} SHPK, në shumën 50.000 euro, më datë 18.08.2010, Komisioni, sërish gjatë seancës dëgjimore e ka relatuar si shënim korrekt, edhe pse subjekti ka sjellë prova se ky ka qenë një gabim i BKT-së.* Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, datë 06.06.2018, i ka kaluar subjektit barrën e provës për mosdeklarimin ndër vite të të ardhurave nga emigracioni, të cilat rezultojnë të tilla nga derdhja në shumën prej 50.000 eurosh, e kryer në BKT, më datë 18.05.2010, në llogari të {***} SHPK, pasi në përshkrimin e këtij veprimi bankar në rubrikën “Burimi i të ardhurave”, subjekti ka shënuar “Nga emigracioni”. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti nuk është shprehur në lidhje me përshkrimin në pagesën prej 50.000 eurosh në BKT, si e kryer me të ardhura nga emigracioni. Relatori i çështjes, në seancën dëgjimore në Komision, datë 02.07.2018, në pasqyrimin e përmbajtjes së dosjes së rivlerësimit për subjektin, ka relatuar ndër të tjera edhe gjetjen e sipërcituar.

48. Duke verifikuar këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit me gjendjen e provave të administruara, rezulton se BKT, në vërtetimin me datë 11.06.2018, deklaroi se në lidhje me veprimin nr. {***}, të datës 18.08.2010, me vlerën 50.000 euro, është përzgjedhur gabimisht

në sistem, burimi i të ardhurave “Nga emigracioni”, pasi klienti nuk ka deklaruar se të ardhurat e tij janë nga emigracioni. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ngarkohet me përgjegjësi në lidhje me përshkrimin e burimit “Nga emigracioni” në dokumentacionin bankar të pagesës së bërë në BKT, prej tij në favor të {***} SHPK, në shumën 50.000 euro, më datë 18.08.2010.

49. Për ish-pasurinë e subjektit të rivlerësimit apartament banimi në Rrugën {*}, Tiranë, me sipërfaqe 120 m² (në vijim apartamenti 120 m²), nga hetimi administrativ ka rezultuar se:**

- ka mospërputhje mes deklarimit të subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe përmbajtjes së kontratës së blerjes së apartamentit në vitin 2004, në lidhje me çmimin dhe datën e saj;
- ka mospërputhje mes deklarimit të subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe përmbajtjes së kontratës në lidhje me çmimin e shitjes së apartamentit, si dhe nuk ka asnjë dokument provues të kryerjes së pagesës efektivisht;
- ka mospërputhje mes deklarimit të subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorëve dhe deklarimeve periodike;
- ka mospërputhje mes deklarimeve dhe përmbajtjes së kontratave, në lidhje me çmimin, me pjesën e tij të paguar, me momentin e pagesës efektivisht;
- ka dyshime të arsyeshme se subjekti ka nënshkruar kontrata noteriale fiktive dhe janë bërë deklarata të ndryshme që nuk përkojnë me realitetin e fakteve.

50. Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjetjet e Komisionit në lidhje me këtë ish-pasuri, nuk janë të drejta, pasi për datën e kontratës së blerjes ka kryer gabim material, ndërsa deklarimi i vlerës së blerjes 55.000 euro në vitin 2004 është lapsus i tij, pasi ka deklaruar vlerën e tregut dhe jo të blerjes. Subjekti pretendon se ky apartament është shitur në vlerën 90.000 euro te shtetasit S.A. dhe N.A. dhe, edhe pse ka lidhur dy kontrata për shitjen e këtij apartamenti, me të njëjtat palë, me të njëjtin çmim dhe përpara të njëjtit noter, çmimin e shitjes e ka përfutuar vetëm një herë, sepse kontrata e parë ka qenë kontratë premtim shitjeje dhe blerësit i kanë likuiduar shumën 2.500.000 lekë, ndërsa kontrata e dytë ka qenë kontratë shitjeje përfundimtare dhe, në ditën e lidhjes së saj, ka përfutuar pjesën e mbetur të detyrimit prej 8.420.000 lekësh.

51. Trupi gjykues i Kolegjit, nga aktet e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, konstaton se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit subjekti ka deklaruar të ardhura nga shitja e një apartamenti me kontratën nr. {*} rep., nr. {***} kol., datë. 20.01.2010, në vlerën 8.420.000 lekë (i cili është blerë sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2004).**

Nga verifikimi i kontratave të cituara, rezulton se kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol. e blerjes së apartamentit është e lidhur më datë 25.08.2004 dhe jo më datë 20.01.2004, siç ka deklaruar subjekti. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ky deklarim i pasaktë është një lapsus i tij. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se kjo pasaktësi materiale në pasqyrimin e datës së lidhjes së kontratës, megjithëse tregon pakujdesi të subjektit ndaj saktësisë së deklarimit, nuk është e mjaftueshme për ta ngarkuar atë me përgjegjësi.

Në paragrafin e tretë të kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.08.2004, çmimi i shitjes së apartamentit është 4.000.000 lekë, në ndryshim nga 55.000 euro sa ka deklaruar subjekti në deklaratën periodike të pasurisë 2004. Subjekti pretendon se çmimi i deklaruar është një gabim i tij, pasi ka deklaruar vlerën e tregut të apartamentit dhe jo vlerën e kontratës së shitblerjes. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën periodike 2004, në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit, duke pasqyruar të dhënat në kundërshtim me sa kërkon neni 4 i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar).

52. Në kontratën e shitblerjes së këtij apartamenti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.08.2004, palët shprehen: “Shitësi deklaron se apartamentin ia shet blerësit kundrejt shumës 4.000.000 lekë. Nga ana e tij, blerësi deklaroi se është dakord me çmimin e shitjes, shumë e cila është likuiduar jashtë kësaj zyre nga blerësi dhe shitësi nuk ka pretendime për to”. Neni 660 i Kodit Civil përcakton: “Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi”, ndërsa në nenin 690: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj.” Bazuar në këto përcaktime, duke vlerësuar fuqinë detyruese të kontratës, në kushtet kur nuk rezulton e provuar që kjo kontratë të jetë ndryshuar nga palët, si dhe duke pasur në konsideratë faktin se apartamenti 120 m² është regjistruar në Zyren Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë (në vijim ZVRPP), më datë 25.10.2004, në emër të subjektit të rivlerësimit,¹³ pala shitëse duhet të ketë transferuar pronësinë, sepse i është likuiduar çmimi prej 4.000.000 lekësh sipas kontratës. Për rrjedhojë, në analizë të fakteve si më sipër, kjo shumë duhet të jetë paguar nga subjekti i rivlerësimit, ashtu siç është parashikuar në kontratën e shitblerjes më datë 25.08.2009, pra para datës së regjistrimit në pronësi të tij të kësaj pasurie të paluajtshme.
53. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit, por edhe në ankim, si dhe gjatë konkluzioneve përfundimtare në Kolegj, ka deklaruar si burim të ardhurash për krijimin e kësaj pasurie një kredi të marrë në Alpha Bank, Gjirokastër, në vlerën 3.500.000 lekë. Nga aktet e administruara, rezulton që kredia e marrë nga subjekti i rivlerësimit në Alpha Bank, Gjirokastër, me kontratë kredie nr. 1011, datë 21.12.2004, është disbursuar më datë 29.12.2004. Sipas të dhënave të llogarisë bankare të subjektit në Alpha Bank, ai më datë 28.12.2004 ka derdhur shumën 500.000 lekë, ndërsa më datë 29.12.2004 ka transferuar për llogari të z. A. M. shumën 4.000.000 lekë, sipas vlerës së kontratës së shitblerjes së apartamentit.
54. Trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi mjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të blerë pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 120 m² në vitin 2004, duke marrë në konsideratë, fuqinë provuese të deklaratës periodike të vitit 2003, bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë deklaratë, subjekti në kundërshtim me sa pretendon, nuk ka deklaruar kursime. Analiza financiare është kryer fillimisht për të vlerësuar aftësinë paguese të subjektit për të kryer derdhjen në shumën 500.000 lekë në Alpha Bank, më datë 28.12.2004, shumë e cila bashkë me vlerën e kredisë prej 3.500.000 lekësh i është kaluar shitësit A.M., përmes Alpha Bank, më datë 29.12.2004.
- Në analizën financiare u konsideruan: a) të ardhurat e ligjshme nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes së tij, bazuar në të dhënat për pagat sipas dokumentacionit provues të administruar nga institucionet përkatëse shtetërore, në vlerën totale 954.820 lekë; b) shpenzimet e njohura të familjes Lazaj të përlllogaritura në vlerën 541.062 lekë, ku përfshihen: i) shpenzime për konsum sipas të dhënave për “*Shpenzimet mesatare mujore sipas llojit dhe rajonit, shpenzimeve, llojit dhe vitit*”, publikuar nga INSTAT¹⁴, në vlerën 500.544 lekë; ii) shpenzimet e udhëtimeve private të kryera nga familja Lazaj jashtë vendit, sipas deklarimeve të vetë subjektit dhe raporteve të sistemit TIMS në vlerën 3.830 lekë; iii) shpenzime për marrjen e kredisë në Raiffesen Bank, më datë 21.12.2009, në vlerën 36.688 lekë; c) ndryshimi i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në vlerën 4.002.516 lekë, ku përfshihen: i) blerja e apartamentit 120 m²; ii) shtesë likuiditetesh në vlerën 2.516 lekë, sipas dokumenteve bankare përcjellë nga

¹³ Sipas dokumentacionit të përcjellë nga subjekti, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit.

¹⁴ <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes/#tab2>.

Alpha Bank, me shkresën nr. {***} prot., datë 02.05.2018; d) detyrime në vlerën 3.500.000 lekë, sipas kontratës së kredisë me Alpha Bank, datë 21.12.2004.

Në përfundim të analizës së të dhënave të pasqyruara si më sipër, rezulton se subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme krijimin e shumës 500.000 lekë të derdhur në Alpha Bank, për të paguar apartamentin 120 m², në vlerën 88.758 lekë. Nëse analiza financiare do të kryhej, sipas parashikimit të kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie deri më datë 25.08.2004, duke mos konsideruar në përlogaritje vlerën e kredisë së marrë në Alpha Bank, atëherë vlera e pajustificuar e burimeve financiare do të ishte 3.673.737 lekë.

Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë apartament me sipërfaqe 120 m², sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

55. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur dy kontrata shitjeje të apartamentit 120 m², me të njëjtat palë, me të njëjtën përmbajtje dhe përpara të njëjtit noter publik, por me data lidhjeje të ndryshme: kontratë shitjeje pasuri e paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.09.2008, dhe kontratë shitjeje pasuri e paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2010. Sipas paragrafit të shtatë të të dyja kontratave, çmimi i shitjes është 90.000 euro dhe jo 8.420.000 lekë, sa ka deklaruar subjekti në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Nga verifikimi i deklaratave periodike të pasurisë së vitit 2008 dhe 2010, rezulton se subjekti ka deklaruar vetëm kontratën e lidhur në vitin 2008 dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e saj, në deklaratën e pasurisë së këtij viti, duke u shprehur se nga shuma e përfitur nga shitja e apartamentit është shlyer kredia në Alpha Bank, në shumën 2.508.000 lekë, është blerë një autoveturë në vlerën 500.000 lekë dhe i kanë mbetur 60.000 euro *cash*. Në deklaratën e vitit 2010 nuk ka deklaruar asnjë kontratë shitjeje dhe, për rrjedhojë, as të ardhura nga shitja.
56. Në lidhje me këtë mospërputhje çmimi dhe ekzistencën e dy kontratave të njëjta, por me data të ndryshme, në përgjigjet që u kthen më datë 24.03.2018 pyetjeve të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Faktikisht nga ana e blerësve janë paguar vetëm 2.500.000 lekë, me të cilat është paguar pjesa e mbetur e kredisë së marrë tek Alpha Bank”. Derisa të paguhej diferenca e shitjes së apartamentit, blerësve nuk u është dhënë në dorë kontrata nga ana ime. Kjo diferencë është shlyer në vitin 2010 dhe meqenëse blerësit e kishin humbur afatin ligjor të regjistrimit të pronës në ZVRPP Tiranë, kemi lidhur një kontratë tjetër shitjeje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.1.2010, te po e njëjta notere, I. Ç., me të njëjtat palë, me të njëjtin objekt, me të njëjtën vlerë shitjeje. Theksoj se nga ky apartament kam përfitur vetëm një herë vlerën e shitjes prej 90.000 eurosh, nga të cilat janë paguar diferenca e kredisë e raportuar vetëm një herë në ILDKPKI.” Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, dërguar në Komision me *e-mail*, më datë 21.06.2018, subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me gjetjet e hetimit për këtë ish-pasuri të tij. Në ankim, si dhe gjatë konkluzioneve në seancën gjyqësore publike në Kolegj, subjekti pretendon se kontrata e parë e lidhur në vitin 2008 ka qenë kontratë premtim shitjeje dhe blerësit i kanë likuiduar shumën 2.500.000 lekë, ndërsa kontrata e dytë ka qenë kontratë shitjeje përfundimtare, dhe në ditën e lidhjes së saj ka përfitur pjesën e mbetur të detyrimit prej 8.420.000 lekësh, si diferencë e papaguar nga kontrata e parë.
57. Në analizë të situatës faktike si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nga përmbajtja e kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.09.2008, nuk evidentohet asnjë

element i një kontrate premtim shitjeje. Në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit në ankim, në nenin 2, pika 1 e kësaj kontrate, palët shprehen: “2.1 Blerësit i kanë paguar shitësit para nënshkrimit të kësaj kontrate të gjithë çmimin e shitjes me transfertë në llogarinë bankare të shitësit, në fonde menjëherë të përdorshme”. Ky përcaktim kontraktor përputhet me atë që ka deklaruar subjekti në deklaratën periodike të vitit 2008, se e ka përfituar të gjithë shumën e shitjes së apartamentit dhe madje edhe e ka përdorur atë, duke shlyer kredinë në Alpha Bank, duke blerë një makinë dhe pjesën e mbetur e ka pasur gjendje *cash*. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka sqaruar arsyen e një deklarimi të tillë në vitin 2008, ndërsa gjatë procesit të rivlerësimit gjithmonë i ka qëndruar pretendimit se ai ka rënë dakord me blerësin për të paguar çmimin me pjesë, sipas mundësive financiare të blerësit. Kontrata e dytë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2010, ka të njëjtën përmbajtje me kontratën e parë të shitjes. Në të nuk ka asnjë nen që të lërë të kuptohet se ka pasur fillimisht një kontratë premtim shitjeje dhe kontrata e dytë është kontrata përfundimtare e shitjes së sendit të paluajtshëm. Arsyeja e lidhjes së kontratës së dytë të shitjes është shpjeguar nga vetë subjekti në përgjigjen e pyetësorit të cituar më sipër, ku pranon se kontrata e dytë është lidhur meqenëse blerësit e kishin humbur afatin ligjor të regjistrimit të pronës. Bazuar në ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar¹⁵, i cili në nenin 12 parashikon: “Nëse një dokument paraqitet për regjistrim më vonë se 30 ditë nga data e realizimit të tij, përveç tarifës së regjistrimit, për çdo ditë vonesë që ka kaluar nga kjo datë, paguhet kamatëvonesë e barabartë me 10 për qind të tarifës së regjistrimit”, rezulton se blerësit nuk humbin afatin ligjor të regjistrimit, por do të duhet të paguanin kamatëvonesën për regjistrimin 2 vjet më vonë nga data e lidhjes së kontratës së shitjes. Trupi gjykues vlerëson se kontrata e dytë e lidhur në vitin 2010 është një kontratë fiktive, jo një kontratë përfundimtare shitjeje siç pretendon subjekti, ndërsa çmimin e shitjes së këtij apartamenti subjekti e ka përfituar vetëm një herë, në vitin 2008.

58. Në konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën periodike të pasurisë në vitin 2004 në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit 120 m²; ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit në lidhje me datën e kontratës së shitjes dhe çmimin e shitjes së apartamentit; ka nënshkruar në vitin 2010 një kontratë të dytë shitblerjeje, fiktive për këtë apartament, si dhe ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar këtë pasuri, bazuar në nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.
59. **Për ish-pasurinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit: apartament prej 83 m², me adresë: Rruga {***}, Banesa nr. {***}, Shk. {***}, Kati {***}, Hyrja nr. {***}, Bulqizë,** në përfundim të hetimit kryesisht të Komisionit ka rezultuar se nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur:
- nuk është deklaruar kjo pasuri për sa i përket pjesës në pronësi të bashkëshortes, as në deklaratën e vitit 2003 dhe as në deklaratat periodike deri në vitin 2013;
 - nuk është deklaruar në deklaratën e vitit 2013, vit në të cilin rezulton kontrata e shitjes së apartamentit në fjalë, e ardhura nga shitja e tij, në shifrën prej 589.715 lekë;

¹⁵ Ligji i kohës. Ky ndryshim në nenin 12 është miratuar me ligjin nr. 9701, datë 2.4.2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar”.

- është bërë deklarim i pasaktë dhe i paplotë në deklaratimet periodike, si dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, duke mos deklaruar një pasuri që ka qenë në pronësi të bashkëshortes.
60. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se gjetjet e Komisionit për ish-pasurinë e bashkëshortes së tij, apartament prej 83 m², në Bulqizë nuk janë të drejta.* Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se gjatë hetimit administrativ kanë rezultuar faktet si më poshtë: bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit A. (Strazimiri) Lazaj ka qenë bashkëpronare (së bashku me shtetasit M.S., S.S. dhe B.S.) e një apartamenti prej 83 m², me adresë: Rruga {***}, Banesa nr. {***}, Shk. {***}, K. {***}, Hyrja Nr. {***}, Bulqizë, me certifikatë për vërtetim pronësie nr. {***}, datë 12.03.2001, i cili është shitur më datë 17.03.2013, me kontratë shitblerje apartamenti nr. {***} rep., nr. {***} kol. në vlerën 2358860 lekë.¹⁶ Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Dibër ka konfirmuar se aktualisht shtetasja A. L. nuk ka të regjistruar asnjë lloj pasurie të paluajtshme.
 61. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit 2017, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë bërë asnjë deklarim në lidhje me të ardhurat e përfituara nga kontrata e shitjes së këtij apartamenti, ndërsa në deklaratat periodike vjetore të pasurisë 2003 dhe/deri 2013, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë bërë asnjë deklarim në lidhje me të drejtën e pronësisë dhe shitjen në vitin 2013, madje bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar nën përgjegjësinë e saj ligjore se nuk disponon pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj.
 62. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit me *e-mail*-in e datës 15.06.2018 i kërkon Komisionit një zgjatje të afatit për të paraqitur shpjegimet në lidhje me rezultatet e hetimit paraprak, pasi ndër të tjera do të paraqiste dëshminë e shtetasit M. S., i cili është një nga shitësit e apartamentit prej 83 m², i shitur me kontratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.10.2013, i cili ndodhet në Bulqizë, me qëllim sqarimin e situatës se cilët kanë qenë personat që kanë përfiturar të ardhura financiare nga kjo shitje.
 63. Nga aktet e administruara rezulton se në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti nuk është shprehur në lidhje me apartamentin prej 83 m², Bulqizë, dhe nuk ka paraqitur prova për të. Në ankim dhe gjatë shpjegimeve përfundimtare në seancë gjyqësore publike në Kolegj, subjekti i rivlerësimit pranon se bashkëshortja e tij ka qenë bashkëpronare në ¼ pjesë takuese të apartamentit 83 m², Bulqizë, i cili është shitur në vitin 2013, por ky apartament nuk është deklaruar asnjëherë si pasuri në deklaratat periodike të pasurisë në vite, me vetëdije, dhe nuk janë deklaruar as të ardhurat nga shitja e tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit 2017 e në atë të pasurisë së vitit 2013. Arsyeja e mosdeklarimeve ka qenë moskonsiderimi i këtij apartamenti si pronë e tyre, pasi me realizimin e martesës bashkëshortët kanë rënë dakord të respektonin me fanatizëm të drejtën zakonore të zonës së Malësisë së Dibrës, krahinës së origjinës së bashkëshortes, duke mos përfiturar asgjë nga pasuria e prindërve të saj. Duke qenë se nuk kanë përfiturar të ardhura, ai nuk kishte si të deklaronte një pasuri që realisht nuk e kishte.
 64. Në analizë të të dhënave të pasqyruara më lart, trupi gjykues i Kolegjit arsyeton se: bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e bashkëpronares në pjesën takuese ¼ ,

¹⁶ Këto të dhëna janë përcjellë nga noteri publik N. Ç., protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 28.02.2018.

presumohet të ketë përfituar nga kontrata e shitjes së apartamentit 83 m², Bulqizë, shumë 589.715 lekë¹⁷. Në cilësinë e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit¹⁸, ajo ka detyrimin e deklarimit të të gjitha pasurive të akumuluar ndër vite dhe paraqitjen e të gjithë dokumentacionit që justifikon vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të tyre, sipas neneve 30 dhe 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në kuptim të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit duhet të kishte deklaruar të ardhurat nga shitja e apartamentit 83 m², Bulqizë, por në rast se nuk i kishte përfituar këto të ardhura, sepse ia kishte dhuruar ato familjes së origjinës, kjo gjë duhet të ishte deklaruar dhe njëkohësisht provuar me dokumentacion justifikues të kohës së përfitimit dhe dhurimit të të ardhurave.

65. Bazuar në nenin 21, paragrafi i parë i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003¹⁹, i cili parashikon se deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit dhe në nenin 22 të po këtij ligji, i cili shprehet se kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit duhet të kishte paraqitur një deklarim veçmas për pjesën takuese të apartamentit 83 m², Bulqizë, pronësinë e të cilit e ka pasur të pacenuar deri në vitin 2013. Në lidhje me deklarimin e të ardhurave nga shitja e këtij apartamenti në vitin 2013, trupi gjykues i mbetet të njëjtit arsyetim si më sipër. Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, që në vitin e miratimit të tij ka pasur të qartë përgjegjësinë ligjore për subjektet e deklarimit dhe personat e lidhur me ta, si dhe sanksionet përkatëse, në rast të mosplotësimit me vërtetësi të deklaratës së pasurisë.
66. Referimi i subjektit të rivlerësimit te traditat krahinore, mund të justifikohet vetëm në momentin e lirisë së disponimit të të ardhurave të përfituara nga kontrata e shitjes së apartamentit nga bashkëshortja e tij, duke vendosur t'i dhurojë ato, por kjo e drejtë zakonore nuk mund të shihet si e lidhur me detyrimin ligjor për deklarimin e të drejtave reale të pasurisë në deklaratat përkatëse periodike. Vlerësimin e prevalencës së legjislacionit në fuqi dhe detyrimin e zbatimit të tij mbi të drejtën zakonore, subjekti, për shkak të pozitës së posaçme si gjyqtar, edhe me një vëmendje minimale, do të duhej ta bënte në çdo rast.
67. Trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si dhe në deklaratimet periodike në vitet 2003 deri 2013, për masën e pjesës takuese dhe për të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij apartamenti, sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016.
68. **Për ish-pasurinë në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit, apartament banimi, me adresë: Lagjja {***}, Vlorë**, në përfundim të hetimit kryesisht të Komisionit ka rezultuar se:
 - subjekti në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 ka deklaruar: apartament me pjesë takuese 50%, i ndodhur në lagjen {***}, Vlorë (burimi nga ligji për privatizimin, vlera në lekë

¹⁷ 2.358.860 lekë : 4 bashkëpronarë = 589.715 lekë.

¹⁸ Në kuptim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit "person i lidhur" është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, për periudhën e rivlerësimit.

¹⁹ Ligji i kohës.

zero), ndërkohë që nga verifikimi rezultoi se ky apartament është shitur që në vitin 2001, me palë shitëse: L. L., K. L. dhe Artan Lazaj, me çmim shitjeje 1.000.000 lekë;

- subjekti ka qenë bashkëpronar me pjesë takuese 1/3 dhe e ka shitur këtë pasuri që në vitin 2001, ndërsa në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit e deklaroi këtë pasuri të shitur në vitin 2012, duke justifikuar me të një të ardhur prej 330.000 lekësh;
- rezultoi një mospërputhje midis përmbajtjes së deklaratave dhe të dhënave konkrete të kontratave dhe, për pasojë, kemi dy deklarime të rreme, si në deklaratën e rivlerësimit, po ashtu edhe në deklaratën e vitit 2003.

69. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se gjetjet e Komisionit për ish-pasurinë në bashkëpronësi të tij apartament banimi, me adresë: Lagjja {***}, Vlorë, nuk janë të drejta, pasi deklarimet e tij për këtë pasuri janë të gabuara, lapsuse, por jo të rreme dhe të qëllimshme.* Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar të ardhura 330.000 lekë nga shitja e një apartamenti ku ka qenë pronar me 1/3 pjesë, me kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.12.2012.

Referuar kontratës së shitblerjes të paraqitur nga vetë subjekti, në funksion të dokumentacionit justifikues për vërtetësinë e deklarimeve në deklaratën e rivlerësimit, rezultoi se kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., për apartament banimi në lagjen {***}, Vlorë, me palë shitëse L. L., K. L. dhe Artan Lazaj, me çmim shitjeje 1.000.000 lekë, është nënshkruar më datë 03.12.2001 dhe jo në vitin 2012, siç pranon dhe vetë subjekti se e ka deklaruar gabimisht, në formën e një pasaktësie materiale.

70. Në analizë të kësaj situatë faktike, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se deklarimi i subjektit, në deklaratën e rivlerësimit, për të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij apartamenti është në përputhje me detyrimet ligjore të formularit të deklarimit të pasurisë së rivlerësimit sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, i cili kërkon që të deklarohen të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite deri në ditën e dorëzimit të kësaj deklarate. Deklarimi i gabuar i datës së lidhjes së kontratës, duket se ka qenë një pakujdesi e subjektit, por që pavarësisht nuk përmban elementet e mjaftueshme për ta ngarkuar atë me përgjegjësi.

71. Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti ka deklaruar se zotëron apartament 1 + 1, lagjja {***}, Vlorë, pjesa takuese 50%, me burim krijimi nga ligji për privatizimin e banesave, por që nga të dhënat e kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.12.2001, e ka shitur që në vitin 2001. Nga provat e administruara dhe në mungesë të një shpjegimi bindës të subjektit për sa i përket pretendimit të tij të paraqitur si gjatë hetimit administrativ, por edhe në ankim, se ka harruar të deklarojë vlerën e përfutur nga shitja e apartamentit në deklaratën e vitit 2003, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i subjektit vjen në kundërshtim me përcaktimet e ligjit të kohës, konkretisht nenin 4, shkronja “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i cili kërkonte deklarimin e të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme. Në këtë kuptim, edhe deklarimi i pjesës takuese 50% nuk është i saktë, pasi sipas kontratës së shitjes së sipërcituar, subjekti ka pasur në pronësi vetëm 1/3 pjesë të apartamentit.

72. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 për të drejtat reale mbi këtë apartament dhe për të ardhurat e përfituara nga shitja e tij, sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

73. **Për pasurinë tokë kullotë, me sipërfaqe 1.000 m², në {***}, Himarë,** në përfundim të hetimit kryesisht të Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit:
- nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe as në atë të vitit 2013;
 - ka deklaruar pjesë takuese ¼ në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ndërkohë që nga kontrata e shitblerjes, ai rezulton si palë blerëse e vetme dhe në deklaratën periodike të vitit 2013 ka deklaruar pjesë takuese 100% dhe jo ¼.
74. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se gjetjet e Komisionit për këtë pasuri nuk janë të drejta, pasi në deklaratën e rivlerësimit, mosdeklarimi i burimit ka qenë neglizhencë nga ana e tij, por burimi i të ardhurave është tërësisht i justifikuar nga të ardhurat familjare dhe se ka deklaruar hipotetikisht pjesët, pasi pyetësi për plotësimin e deklaratës ndryshon nga parashikimet e Kodit të Familjes.* Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë së sipërcituar, në kundërshtim me nenet 30 dhe 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe me sa kërkon objekti i deklarimit, në pjesën hyrëse të rubrikës së formularit të deklarimit. Subjekti, në ankim, pretendon se mosdeklarimin e burimit të krijimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit e ka kryer në kushtet e neglizhencës dhe harresës, por për vetë pozicionin e tij si subjekt rivlerësimi dhe për vetë rëndësinë e procesit të rivlerësimit, neglizhenca dhe harresa nuk janë të justifikuara e sidomos kur formulari i deklarimit që në faqet e para informon se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës së pasurisë, mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, e njëkohësisht edhe udhëzimi i datës 10.10.2016 i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, sqaron detyrimin për deklarimin e burimit të krijimit të pasurisë.
75. Nga shqyrtimi i kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.08.2013, të pasurisë së paluajtshme tokë me sipërfaqe 1.000 m², në {***}, Himarë, Vlorë, rezulton se palë blerëse është Artan Lazaj, i cili sipas informacionit të administruar, përcjellë nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë²⁰, është pronar i vetëm i kësaj pasurie të regjistruar në nenin hipotekor {***}, datë 30.07.2013, në zk. {***}, Himarë. Për pasojë, subjekti do të duhej të deklaronte si pjesë takuese 100% të kësaj pasurie dhe jo ¼ e saj, pasi formulari i deklarimit të pasurisë kërkon deklarimin e pjesës takuese reale, që zotëron subjekti në momentin e deklarimit. Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit, deklarimin e pjesës 1/4 e pretendon për faktin se pyetësi për plotësimin e deklaratës së rivlerësimit ndryshon konceptualisht nga sa është parashikuar në Kodin e Familjes mbi bashkësinë, prandaj ai ka ndarë hipotetikisht pjesët, duke qenë se familja e tij përbëhet nga 4 anëtarë: bashkëshortët dhe dy fëmijët, por ky justifikim është në kundërshtim me përkufizimin e pasurisë të përcaktuar në nenin 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016 dhe me sa kërkon formulari i deklarimit të pasurisë së rivlerësimit për deklarimin e të drejtave reale mbi pasuritë dhe deklarimin e pjesëve zotëruese, pra jo pjesëve hipotetike të pasurisë së subjektit deklarues.

²⁰ Përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 04.09.2017, dhe protokolluar në ILDKPKI me nr. {***} prot., datë 8.09.2017.

Subjekti në deklarinimin për herë të parë të kësaj pasurie, në deklaratën periodike të vitit 2013 nuk ka deklaruar burimin e krijimit të saj, ashtu siç urdhëron neni 4, paragrafi i parë i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, duke kryer kështu deklarinim të pasaktë.

76. Trupi gjykues i Kolegjit analizoi mjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme të subjektit për të krijuar pasurinë e paluajtshme “tokë” me sipërfaqe 1.000 m², në vlerën 200.000 lekë, deri në datën e lidhjes së kontratës së shitjes, 21.08.2013, pasi në këtë kontratë palët shprehen se likuidimin e shumës prej 200.000 lekësh e kanë kryer jashtë zyrës noteriale dhe nuk kanë asnjë pretendim për të. Në analizën financiare u konsideruan: a) të ardhurat e ligjshme nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes së tij, sipas vërtetimeve të pagave të administruara gjatë hetimit administrativ, nga institucionet shtetërore përkatëse, të cilat janë përlllogaritur në total në vlerën 1.532.659 lekë; b) shpenzimet e njohura të familjes Lazaj të përlllogaritura në vlerën 1.213.109 lekë, duke konsideruar: i) shpenzimet për konsum, bazuar në “Shpenzimet mesatare mujore sipas llojit dhe rajonit, shpenzimeve, llojit dhe vitit” sipas INSTAT në vlerën 676.703 lekë; ii) interesat e paguara për kredinë e marrë në Raiffeisen Bank në vitin 2009 në vlerën 258.128 lekë; iii) shpenzimet minimale të udhëtimeve private jashtë vendit të kryera nga familja Lazaj, sipas deklarimeve të vetë subjektit dhe raporteve të sistemit TIMS në vlerën 278.277 lekë; c) ndryshimi i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në vlerën 996.742 lekë. Në përfundim, rezulton se subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme në vlerën 791.883 lekë, blerjen e pasurisë tokë me sipërfaqe 1.000 m².
77. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë tokë me sipërfaqe 1.000 m², ka kryer deklarinim të pamjaftueshëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit për mosdeklarinim të burimit financiar dhe pasqyrim të të dhënave pasurore jo të sakta për pjesët takuese, si dhe ka kryer deklarinim të pasaktë në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2013, sipas nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.
78. **Për automjetin {***}, viti i prodhimit 1997, në ish-pronësi të subjektit të rivlerësimit, në përfundim të hetimit kryesisht të Komisionit ka rezultuar se:**
- ka dyshime të arsyeshme se çmimi 125.000 lekë i blerjes së automjetit {***} prej subjektit të rivlerësimit në vitin 2010 nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhe çmimi i shitjes së këtij automjeti në vitin 2015 me çmimin 5.000 euro nuk pasqyrojnë realitetin, pasi ka një diferencë të konsiderueshme mes tyre dhe çmimeve mesatare të tregut, e sidomos kur në kontratën e shitjes palët kanë pranuar që në rast se nuk bëhet i mundur transferimi i pronësisë, blerësi e merr automjetin për pjesë këmbimi.
79. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se gjetjet e Komisionit nuk bazohen në provat e paraqitura prej tij, sa i përket blerjes nëpërmjet privatizimit dhe shitjes së kësaj makine në vlerën 5.000 euro.* Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se sipas dokumentacionit të administruar, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit subjekti ka deklaruar të ardhura nga shitja e automjetit {***}, viti i prodhimit 1997, në vlerën 5.000 euro, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.09.2015.
- Në deklaratën periodike të vitit 2010 ka deklaruar blerjen e këtij automjeti, nëpërmjet privatizimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në vijim KQZ) për shkak të detyrës së tij si

anëtar në këtë Komision, në vlerën 125.000 lekë, ndërsa në deklaratën e vitit 2015 ka deklaruar shitjen në vlerën 5.000 euro.

80. Rezulton e provuar sipas dokumentacionit të administruar, se subjekti në periudhën 02.02.2009 - 17.10.2012 ka ushtruar detyrën e anëtarit të KQZ-së.
81. Nga shqyrtimi i kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.09.2015, rezulton se subjekti i rivlerësimit ia ka shitur automjetin në fjalë shtetasit Q.M. me çmimin prej 5.000 eurosh. Pala blerëse, z. Q.M., në momentin e blerjes ka deklaruar se ka marrë në dorëzim këtë mjet më datë 29.09.2015 dhe se merr përsipër transferimin e pronësisë në emër të tij, por nëse nuk bëhet i mundur transferimi i pronësisë, e merr automjetin për pjesë këmbimi.
82. Në ankim dhe në shpjegimet përfundimtare në seancë gjyqësore në Kolegj, subjekti pretendon se automjetin e markës “Mercedes-Benz” e ka përfituar në vitin 2010, si anëtar i KQZ-së, me vlerë blerjeje të ulët, si rezultat i procesit të privatizimit, sipas një vendimi të Këshillit të Ministrave, por e ka shitur në vitin 2015 me vlerë 5.000 euro, pasi ka qenë në gjendje shumë të mirë teknike dhe është përdorur shumë pak nga viti 2010 deri në vitin 2015. Si bazë ligjore e kontratës së shitblerjes së automjetit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.03.2010, me palë blerëse A. Lazaj dhe shitëse KQZ, është cituar ligji nr. 10160, datë 15.10.2009, “Për rregullimin e transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”.
83. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, mbështetur në gjendjen faktike si më sipër cituar, arsyeton se në periudhën kur subjekti ka ushtruar detyrën e anëtarit të KQZ-së, ligji nr. 10160, datë 15.10.2009, “Për rregullimin e transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë” në nenin 8 parashikonte: “Të gjitha automjetet e tepërta, në dispozicion të ministrive, institucioneve qendrore dhe të varësisë shiten me ankand, në të cilin e drejta e parablerjes u takon funksionarëve të kategorive të trajtuara në pikat 2 e 3 të nenit 2 të këtij ligji. Ministrinë, institucionet qendrore dhe të varësisë ngrenë, me urdhër të titullarit, komisionet e organizimit të procedurave të ankandit me jo më pak se 5 anëtarë. Rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit dhe kriteret e vlerësimit të pronës, që do të nxirret në ankand, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.” Në zbatim të këtij ligji, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 1242, datë 16.12.2009, “Për rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit, kriteret e vlerësimit të pronës, që nxirret në ankand, si dhe për mënyrën e indeksimit të përfitimit financiar mujor”, i cili në paragrafin IV, pika 1 detajon mënyrën e përlllogaritjes së vlerës fillestare të mjetit që do të dalë në ankand, sipas kësaj metode: “Komisionet, për të llogaritur vlerën e mjetit të transportit, që do të dalë në ankand, do t’i referohen tabelës së dërguar nga zyra doganore, e cila ka përdorur si burim informacioni buletinet, që pasqyrojnë çmimet e shitjes në tregjet evropiane. Vlerës së gjendur në tabelë, i zbritet 50% si koeficient amortizimi për shkak të përdorimit të mjetit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Vlera e mbetur është vlera e mjetit të transportit, e cila do të jetë edhe vlera fillestare e ankandit.” Më tej, vendimi i Këshillit të Ministrave shpjegon se komisioni i ankandit, pas llogaritjes së vlerës fillestare, harton njoftimin, i cili, së bashku me dokumentacionin për mjetin, i ofrohet, së pari, nëse ka, zyrtarit në dispozicion të të cilit është mjeti, i cili duhet që, brenda tri ditëve pune, të kthejë përgjigje me shkrim, për pranimin ose jo të ofertës, si dhe për kushtet e pagesës.

Nga përmbajtja e normave rregulluese të mësipërme, qartësohet mënyra e përlllogaritjes së çmimit të shitjes së automjetit të markës “Mercedes-Benz” nga KQZ, si dhe kushtet e mënyra e blerjes së këtij automjeti, nga subjekti i rivlerësimit, për çmimin 125.000 lekë.

84. Për sa i përket çmimit prej 5.000 eurosh të shitjes së automjetit nga subjekti i rivlerësimit, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.09.2015, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, nisur nga gjendja faktike se kontrata e shitjes së automjetit është në formën e kërkuar nga ligji dhe nuk provohet fiktiviteti i saj, sipas parashikimeve të neneve 92 e 93 të Kodit Civil, çmimi prej 5.000 eurosh është një përputhje mes kërkesë-ofertës së dakordësuar me vullnet të plotë e të pavesuar të palëve kontraktuale.
85. **Për shpenzimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit për arsimimin e vajzës së tij**, nga hetimi administrativ në Komision ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit:
- nuk ka deklaruar si shpenzim shumën prej 1.700 eurosh për shkollimin e vajzës së tij, në deklaratën periodike të vitit 2015;
 - nuk ka deklaruar si shpenzim shkollimi, shumat prej 3.780 eurosh dhe 4.800 eurosh në deklaratën periodike të vitit 2016;
 - nuk është deklaruar në total shuma prej 10.280 eurosh si shpenzime për shkollimin e vajzës dhe, për rrjedhojë, nuk është deklaruar as burimi i të ardhurave me të cilat është mundësuar përballimi i këtyre shpenzimeve;
 - shpenzimet e mësipërme nuk rezultojnë të deklaruara as në përgjigjet ndaj pyetësorit, më datë 26.12.2017;
 - ka dyshime të arsyeshme, se janë bërë deklaratat të pasakta dhe të paplota në deklaratimet periodike dhe në deklaratën e rivlerësimit.
86. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se gjetjet e Komisionit janë të njëanshme e arbitrare, pasi nuk janë pranuar sqarimet e tij se ai nuk i ka deklaruar këto shpenzime për arsimimin e vajzës në deklaratat e pasurisë, duke qenë se ato janë të justifikuara nga kursimet familjare ndër vite.* Trupi gjykues i Kolegjit, nga provat e administruara, konstaton se subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e kthjera më datë 26.12.2017 pyetjeve të Komisionit deklaroi se vajza e tij, studimet 9-vjeçare i ka kryer në institucionet publike, ndërsa ato të mesme në institucione jopublike, në dy të tilla: {***} dhe {***}, ndërsa në përgjigjet e kthjera, më datë 24.03.2018, në ndryshim nga pyetësori i parë deklaroi se edhe klasën e 9-të të arsimit 9-vjeçar, vajza e tij e ka kryer në shkollën jopublike {***}.
- Nga shqyrtimi i vërtetimeve të lëshuara nga institucionet arsimore jopublike, rezultoi se subjekti ka kryer këto pagesa për arsimimin e vajzës në institucionin {***}²¹: për vitin akademik 2015-2016 (klasa e 9-të) paguar shuma prej 5.480 eurosh. Pagesa është kryer në dy këste, përkatësisht kësti i parë prej 1.700 eurosh më datë 02.11.2015 dhe kësti i dytë prej 3.780 eurosh më datë 24.06.2016; për vitin akademik 2016-2017 (klasa e 10-të) paguar shuma prej 6.600 eurosh. Pagesa është kryer në dy këste, përkatësisht kësti i parë prej 4.800 eurosh më datë 13.09.2016 dhe kësti i dytë prej 1.800 eurosh më datë 11.05.2017.
- Në shpërndarje të këtyre shpenzimeve sipas viteve kalendarike, rezultoi se në vitin 2015 subjekti ka paguar shumën 1.700 euro, ndërsa në vitin 2016 shumën 8.580 euro.

²¹ Pagesat e bëra për institucionin arsimor {***}, janë kryer pas dorëzimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit 2017.

87. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, mbështetur në gjendjen faktike si më sipër cituar, arsyeton se formulari i deklarimit periodik të pasurisë, në rubrikën “Shpenzime të deklarueshme”, në përputhje me nenin 4, shkronja “h” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, detyron subjektet deklaruese të përshkruajnë hollësisht çdo shpenzim me vlerë mbi 300.000 lekë, si: për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arretim e të tjera të këtij lloji, të kryera nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit. Vlera e pagesave, të kryera nga subjekti për arsimimin e vajzës deri më 31 dhjetor 2015, nuk ka pasur vlerën mbi 300.000 lekë, për pasojë ai nuk kishte detyrimin t’i deklaronte si shpenzim për këtë vit deklarimi. Ndërsa në deklarimin periodik të pasurisë 2016, subjekti nuk ka deklaruar pagesat në shumën prej 8580 euro, e cila tejkalon kufirin ligjor të mosdeklarimit prej 300.000 lekësh dhe, për rrjedhojë, nuk ka deklaruar as burimin e të ardhurave për kryerjen e këtyre pagesave. Për sa i përket pretendimit të subjektit se këto shpenzime nuk i ka deklaruar, pasi të ardhurat me të cilat janë kryer këto shpenzime janë tërësisht të justifikuar nga të ardhurat nga marrëdhëniet e punës së tij dhe bashkëshortes, trupi gjykues i Kolegjit çmon se detyrimi i deklarimit të pasurive apo shpenzimeve nuk lidhet me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave për krijimin e tyre, në kuptimin që një burim i ligjshëm nuk justifikon në asnjë rast mosdeklarimin.
88. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontrata me institucionet arsimore të përmendura më sipër dhe duke qenë se ende kishte detyrime të pashlyera ndaj tyre, ai duhet të kishte deklaruar pjesën e mbetur të detyrimit për arsimimin e vajzës së tij për vitin 2017, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”. Për pasojë, subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.
89. Trupi gjykues analizoi mjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme të subjektit dhe personit të lidhur, për të justifikuar shpenzimet e kryera në shumën 8.580 euro ose 1.178.594 lekë (konvertuar në lekë sipas kursit të këmbimit 1 euro = 137,36 lekë²²), për periudhën 01.01.2016 – 13.09.2016. Në analizën financiare u konsideruan: a) të ardhurat e ligjshme nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes së tij, sipas vërtetimeve të pagave të administruara gjatë hetimit administrativ, nga institucionet shtetërore përkatëse, të cilat janë përlllogaritur në total në vlerën 1.419.359 lekë; b) shpenzimet e njohura të familjes Lazaj të përlllogaritura në total në vlerën 2.497.698 lekë, ku përfshihen: i) shpenzimet për konsum sipas “Shpenzimeve mujore për konsum sipas madhësisë së njësisë ekonomike familjare”, publikuar nga INSTAT në vlerën 696.107 lekë; ii) shpenzimet minimale të udhëtimeve private të kryera nga familja Lazaj jashtë vendit, sipas deklarimeve të vetë subjektit dhe raporteve të sistemit TIMS në vlerën 485.284 lekë; iii) interesat e paguara për kredinë e marrë në Raiffeisen Bank në vitin 2009 në vlerën 137.711 lekë; iv) shpenzimet për arsimimin e vajzës në vlerën 1.178.594 lekë; c) ndryshimi i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në vlerën 451.310 lekë. Në përfundim, rezulton se subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme, në vlerën 1.739.347 lekë, shpenzimet për arsimimin e vajzës së tij gjatë vitit 2016.
90. Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për kryerjen e shpenzimeve për arsimimin e vajzës

²² Kursi i këmbimit euro - lekë më datë 13.09.2016.

së tij për vitin 2016; ka kryer deklarin të pasaktë në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2016, duke mos deklaruar shpenzimet në shumën 8.580 euro, të kryera si pagesa për arsimimin e vajzës së tij dhe, për rrjedhojë, nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për kryerjen e këtyre shpenzimeve; ka kryer deklarin të pamjaftueshëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit për pjesën e mbetur të detyrimit për arsimimin e vajzës së tij, bazuar në nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 33 pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

91. **Analiza financiare për burimin e ligjshëm të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit**
Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka kryer analizën financiare për periudhën 2004-2016, për burimin e ligjshëm të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, duke arritur në përfundimin se të ardhurat e ligjshme të realizuara nga subjekti i rivlerësimit nuk kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar blerjet e pasurive të paluajtshme, likuiditetet në bankë dhe *cash-in* në banesë, si dhe për të kryer shpenzimet jetike dhe ato të deklaruara.
92. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk është i qartë për metodologjinë e analizës financiare të Komisionit dhe, për këtë arsye, ka kryer vetë një analizë financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të tij për periudhën 1994-2016, nga e cila rezulton se në çdo vit, disponibiliteti i burimeve financiare ka qenë i mjaftueshëm për të përballuar shpenzimet e kryera nga familja e tij dhe për krijimin e kursimeve ndër vite.* Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni në analizën financiare, për të cilën i ka kaluar subjektit barrën e provës, i ka bërë të njohur dokumentacionin mbi të cilin ka mbështetur të dhënat e përdorura, mënyrën se si i ka përlllogaritur shpenzimet e jetesës, si dhe llogaritjet tabelore sipas të cilave ka rezultuar se subjekti ka pasur diferenca negative të të ardhurave dhe shpenzimeve.
93. Trupi gjykues i Kolegjit, me qëllim shqyrtimin e drejtë të shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe të shpjegimeve të paraqitura prej tij edhe në seancë gjyqësore publike në Kolegj, analizoi mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të për periudhën 2004-2016, duke i bazuar përlllogaritjet financiare në deklarinin e pasurisë së rivlerësimit, në deklarinimet periodike vjetore të pasurisë, në përgjigjet dhe shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, në dokumentacionin justifikues të paraqitur prej tij, si dhe në provat shkresore të administruara nga institucionet publike dhe private. Trupi gjykues i Kolegjit, ashtu siç është shprehur edhe më sipër në arsyetimin e tij, e ka kryer analizën financiare duke filluar nga viti 2004, pasi në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti më 31 dhjetor 2003 nuk ka deklaruar kursime *cash* ose likuiditete në bankë. Në analizën financiare për këtë periudhë, trupi gjykues i Kolegjit ka përdorur të njëjtën metodologji si më sipër²³ në vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 158,1 m². Rezultatet e të dhënave tregojnë se për vitin 2004, subjekti nuk justifikon krijimin e pasurive dhe shpenzimet e kryera në vlerën 88.758 lekë; për vitin 2006 në vlerën 849.098 lekë; për vitin 2007 në vlerën 532.104 lekë; për vitin 2008 në vlerën 1.439.639 lekë; për vitin 2009 në vlerën 622.301 lekë; për vitin 2010 në vlerën 1.253.979 lekë; për vitin 2011 në vlerën 7.202.514 lekë; për vitin 2012 në vlerën 371.914 lekë; për vitin 2013 në vlerën 1.068.565 lekë; për vitin 2014 në vlerën 596.042 lekë; për vitin 2015 në vlerën 654.384 lekë; për vitin 2016 në vlerën 1.591.392 lekë. Subjekti justifikon krijimin e pasurive dhe shpenzimet e kryera vetëm për vitin 2005, në vlerën 74.839 lekë.
94. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se të ardhurat e përfituara nga burime të njohura, të ligjshme, nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, nuk kanë qenë të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e pasurive të luajtshme e të paluajtshme ndër vite, krijimin e kursimeve nga pagat e deklaruara në deklarinimet periodike, likuiditetet në bankë, si dhe shpenzimet e kryera

²³ Shih paragrafët 40-42 të këtij vendimi.

për jetesë, udhëtime, arsimim, shlyerje kredie bankare etj., bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

95. Trupi gjykues, pasi analizoi situatën faktike të krijimit dhe deklarimit për të gjitha pasuritë e subjektit të rivlerësimit, lidhur këto me provat e administruara në këtë çështje, arriti në këto konkluzione:

1. Për pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 158,1 m² (177 m² bashkë me mjediset e përbashkëta), me adresë: Rruga {***}, pallati {***}, hyrja {***}, apartamenti {***}, Njësia Nr. {***}, Tiranë, rezulton se subjekti i rivlerësimit:

a) ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në deklarimin e pasurisë së rivlerësimit 2017 për pjesët takuese dhe mosdeklarim të burimit të krijimit të këtij apartamenti;

b) ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2010, duke mos deklaruar të drejtat reale që rridhnin nga kontrata e sipërmarrjes për apartamentin;

c) ka kryer deklarim të pasaktë në vitin 2011 për vlerën e apartamentit;

ç) ka pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme për të paguar detyrimet ndaj shoqërisë {***} SHPK, sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.11.2010.

2. Për ish-pasurinë apartament banimi në Rrugën {***}, Tiranë, me sipërfaqe 120 m², rezulton se subjekti i rivlerësimit:

a) ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit 2017 në lidhje me datën e kontratës së shitjes dhe çmimin e shitjes së këtij apartamenti;

b) ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën periodike të pasurisë në vitin 2004 në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit;

c) ka nënshkruar në vitin 2010 një kontratë të dytë shitblerjeje, fiktive për këtë apartament;

ç) ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar këtë pasuri.

3. Për ish-pasurinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, apartament prej 83 m², me adresë: Rruga {***}, banesa nr. {***}, shk. {***}, k. {***}, hyrja nr. {***}, Bulqizë, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë kryer deklarim të pamjaftueshëm, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit 2017, si dhe në deklarimet periodike në vitet 2003 deri 2013, për masën e pjesës takuese dhe për të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij apartamenti.

4. Për ish-pasurinë në bashkëpronësi apartament banimi, me adresë: Lagjja {***}, Vlorë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 për të drejtat reale mbi këtë apartament dhe për të ardhurat e përfituara nga shitja e tij.

5. Për pasurinë tokë kullotë, me sipërfaqe 1.000 m², në {***}, Himarë, rezulton se subjekti i rivlerësimit:

a) ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit 2017, duke mos deklaruar burimin financiar dhe duke pasqyruar të dhëna pasurore jo të sakta për pjesët takuese;

b) ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2013;

c) ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar këtë pasuri.

6. Për shpenzimet e kryera për arsimimin e vajzës së tij, rezulton se subjekti i rivlerësimit:

a) ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit 2017 për pjesën e mbetur të detyrimit për arsimimin e vajzës së tij;

b) ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2016, duke mos deklaruar shpenzimet në shumën 8.580 euro, të kryera si pagesa për arsimimin e vajzës së tij dhe, për rrjedhojë, nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për kryerjen e këtyre shpenzimeve;

c) ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të paguar shumën 8.580 euro, si pagesa për arsimimin e vajzës së tij.

7. Nga analiza financiare e kryer për periudhën 2003-2016, rezulton se të ardhurat e përfituara nga burime të njohura, të ligjshme, nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, nuk kanë qenë të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e pasurive të luajtshme e të paluajtshme ndër vite, krijimin e kursimeve nga pagat e deklaruara në deklaratimet periodike, likuiditetet në bankë, si dhe shpenzimet e kryera për jetesë, udhëtime, arsimim, shlyerje kredie bankare etj.

96. Subjekti i rivlerësimit rezulton se ka në pronësi pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht dhe njëkohësisht nuk ka deklaruar plotësisht pasuritë e tij. Për këtë arsye, nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë në përputhje me nenin 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

97. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në kuptim të pikave 3 dhe 5 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, me shumicë votash, bazuar në nenet D, pikat 3 e 5 dhe F të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 61, pika 3, sipas parashikimeve të nenit 33, dhe 66, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Prishjen e vendimit nr. 34, datë 11.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Artan Lazaj.
2. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Lazaj.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 31.01.2019.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi - kundër

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi - kundër

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM I PAKICËS

1. Ne, gjyqtarët Rezarta Schuetz dhe Ardian Hajdari, jemi të mendimit se çështja nr. 15/2018 (JR), datë 11.09.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit Artan Lazaj, duhet të ishte zhvilluar e të kishte përfunduar në seancën e datës 09.01.2019, në dhomë këshillimi. Sipas nesh, pakicës, vendimi nr. 34, datë 11.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), i parë në tërësinë e tij, ishte i drejtë, i bazuar në prova e në ligj dhe duhej lënë në fuqi nga trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
2. Jemi dakord me shumicën që gjykimi i kërkesës së subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e komisioneres Brunilda Bekteshi nga i njëjti trup gjykues në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit bie ndesh me kërkesat e nenit 27, pika 2, fjalja e fundit e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit: “[...] Përjashtimi i komisionerit, gjyqtarit ose Komisionerit Publik nga shqyrtimi i çështjes vendoset nga një tjetër trup gjykues që caktohet me short. [...]” Ky parim gjen zbatim edhe referencë të drejtpërdrejtë edhe në “Hapa proceduralë të unifikuar”, pika 7, miratuar nga Komisioni. Për rrjedhojë dhe në vijim të këtyre dispozitave, kërkesa e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e komisioneres duhet të vinte në lëvizje caktimin e një trupi tjetër gjykues, ndryshe nga sa rezulton të ketë ndodhur. Mosshqyrtimi i kërkesës për përjashtim të një komisioneri nga një trup gjykues tjetër, është një gabim procedural serioz.
3. Nga ana tjetër, ne mendojmë se ky gabim procedural i Komisionit mund dhe duhej korrigjuar nëpërmjet arsytimit të vendimit, duke orientuar Komisionin që në çështje të ngjashme të ndjekë dispozitat e sipërcituara në paragrafin 2. Në vlerësimin e pakicës, ky gabim procedural i trupit gjykues të Komisionit, në vetvete dhe parë në kontekstin e gjithë procedurës së ndjekur për subjektin në fjalë në Komision, nuk rezulton ta ketë bërë vendimin e Komisionit të padrejtë dhe të cenueshëm në tërësinë e vet, aq me tepër të pavlefshëm.
4. Ky vlerësim bazohet në rrethana që lidhen me thelbin (siç shtjellohet më poshtë) dhe në analizën e garancive procedurale të procesit të rregullt, të cilat subjekti duket se i ka gëzuar plotësisht, përfshirë (dhe jo vetëm): njohjen me fashikullin, mundësinë për të dhënë shpjegime me shkrim dhe me gojë gjatë procesit të hetimit administrativ nëpërmjet pyetësorëve, si edhe në seancën dëgjimore, dhe kohën e mjaftueshme për t’u përgatitur²⁴, duke pasur parasysh edhe që në asnjë parashtrim të tijin subjekti nuk kundërshton kohën e vënë në dispozicion nga Komisioni apo njohjen me fashikullin apo mundësinë për të parashtruar argumentet e tij.
5. Nga fashikulli rezulton që subjekti i rivlerësimit Artan Lazaj ngriti dy kundërshtime lidhur me interpretimin e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sa i përket rivlerësimit të tij të bazuar vetëm në kriterin pasuror dhe respektivisht për të përjashtuar të gjithë trupin gjykues më 28.06.2018, pasi ky i fundit interpretoi ligjin në mënyrë tekstuale. Nga fashikulli, rezulton se vetëm pasi u hodh poshtë kërkesa për përjashtimin e gjithë trupit gjykues, 46 ditë pasi subjekti i rivlerësimit kishte pranuar me shkrim gjatë komunikimit elektronik se nuk kishte pretendime lidhur me anëtarët e trupit gjykues, ai ngriti pretendime lidhur me mungesën e paanësisë së komisioneres.

²⁴ Hetimi administrativ në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit është mbyllur më 06.06.2018 dhe subjekti i është njoftuar një afat prej 10 ditësh për t’u njohur me rezultatet e hetimit. Shih fashikullin 6 të Komisionit dhe vendimin nr. 3 të trupit gjykues nr. 3 të Komisionit. Seanca dëgjimore u caktua më 28.06.2018 dhe vazhdoi edhe më 2.07.2018.

6. Në parashtrimet e tij, përfshirë edhe ato në seancën publike përpara trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, subjekti i rivlerësimit Artan Lazaj nuk arriti të provonte që vendimi i marrë unanimisht nga trupi gjykues i Komisionit, për sa i përket thelbit të rivlerësimit të subjektit, ishte i padrejtë dhe i pabazuar në ligj. Konstatimi ynë bazohet edhe në standardet e vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim GJEDNJ).
7. Sipas jurisprudencës së kësaj të fundit, vlerësimi i një pretendimi për mungesë paanësie sipas standardit të vendosur në *Hauschildt kundër Danimarkës*²⁵ duhet t'i nënshtrohet analizës rigorozë të elementeve objektive dhe subjektive. Referuar edhe çështjeve paraardhëse, gjykata theksoi: “[...] Ekzistenca e paanësisë për qëllim të nenit 6, pika 1, duhet të analizohet bazuar në një testim me natyrë subjektive, me fjalë të tjera, mbi bazën e bindjes personale të një gjyqtari në një çështje të caktuar, dhe testit objektiv, me fjalë të tjera, pasi të vërtetohet që gjyqtari ofroi garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim.”²⁶ Po ashtu, në procesin e analizës kundrejt këtyre elementeve, “mendimi i palës që pretendon anshmëri ngre peshë, por nuk është vendimtar; është thelbësore që dyshimi mbi mungesën e paanshmërisë të justifikohet objektivisht. [...]”²⁷
8. Duke zbatuar këto parime në rastin konkret, meqenëse nuk vihet në diskutim paanshmëria objektive, subjektit i binte barrë të provonte që komisionerja me bindjen dhe sjelljet e saj demonstroi që kishte paragjykuar subjektin. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, bindja e brendshme provohet ndër të tjera, nga vendime të mëparshme të të njëjtit gjyqtar lidhur me të njëjtin individ, për të njëjtat çështje në diskutim, siç ishte për shembull *Werner kundër Polonisë*.
9. Nga analiza e thënieve të subjektit të rivlerësimit Artan Lazaj, nga procesverbali i seancës dhe dokumentet lidhur me hetimin administrativ, parë në kontekstin e testit që vendos jurisprudenca e GJEDNJ-së në *Hauschildt*, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për paragjykim nga komisionerja, bazuar në vlerësimin e tij personal, apo akuzat e pavërtetuara për manipulim me procesverbalin mbeten pretendime me karakter perceptimi të njëanshëm të vetë subjektit të rivlerësimit, opinione që për mendimin e pakicës nuk arriten nivelin e provës objektive që është element kyç në vlerësimin që anshmëria u arsyetua objektivisht. Me më pak rëndësi por me vlerë ilustruese, vlen të përmendet fakti që vendimi në trupin gjykues të Komisionit u mor unanimisht, gjë që tregon se vendimi për vlerësimin mbi kriterin pasuror dhe masa disiplinore e marrë për subjektin nuk ishte rezultat rastësor, as i mbledhjes aritmetike të votave, por rezultat i një analize faktesh dhe provash që bindi tre komisionerë.
10. Pretendimet e pavërtetuara të subjektit të rivlerësimit për manipulim me procesverbalin, apo perceptimi nga ana e tij i komunikimit verbal me komisioneren, nuk arrijnë në nivelin e justifikimit objektiv (shih më sipër) të mungesës së paanshmërisë që kërkohet nga jurisprudenca e GEDNJ-së në zbatim të nenit 6, pika 1 e Konventës.

²⁵[https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-57500%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-57500%22]})

²⁶ Piersack kundër Belgjikës A 53 (1982) 5 EHRR 169, që shërbeu si referencë për Hauschildt kundër Danimarkës A 154 (1989); 12 EHCR 266 paragrafi 46.

²⁷ Hauschildt kundër Danimarkës, paragrafi 48.

11. Ky përfundim bazohet edhe në thëniet e subjektit në seancën dëgjimore në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, më 23.01.2019. Në atë seancë, në vlerësimin tonë, subjekti nuk arriti të provojë që vetëm prania e komisioneres Bekteshi në trupin gjykues ndikoi negativisht vlerësimin e kriterit pasuror në rivlerësimin e tij kalimtar, sipas nenit 4 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti, përkundrazi, i vuri rëndësi të veçantë të drejtës së tij numerikisht të pakufizuar për të kërkuar përjashtimin e të gjithë trupit gjykues apo të anëtarëve të tij të veçantë.
12. Ne, anëtarët e mendimit të pakicës, çmojmë se debati në seancë gjyqësore me praninë e palëve ishte i panevojshëm, sepse: a) konstatimi i gjendjes faktike ishte bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja nuk nevojitej; b) nuk konstatojmë shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje, apo gjendje faktike të konstatuar gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; c) vlerësojmë se nuk ishte e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të marra në Komision. Me fjalë të tjera, vlerësojmë se nuk jemi para kërkesave të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të cilit i referohet neni 65 i ligjit nr. 84/2016.
13. Debati gjyqësor, përveçse i panevojshëm, ishte edhe i pamundur për shkak të mungesës së Komisionerit Publik në seancë gjyqësore. Për më tepër, ky debat nuk ishte kërkuar nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet ankimit.
14. Ne anëtarët në pakicë të trupit gjykues votuam kundër vendimit për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë publike, pasi nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit në funksion të shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, konstatuam se asnjë nga shkaqet e ankimit nuk cenonte vendimin e Komisionit në themel, e akoma më pak vinte në dyshim gjendjen faktike të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.
15. Duke vlerësuar se vendimi nr. 34, datë 11.07.2018, i Komisionit nuk është i pavlefshëm, çmojmë që në funksion të kërkesave të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 të orientojmë Komisionin që për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në lidhje me kërkesat e subjekteve të rivlerësimit për përjashtimin e anëtarëve të Komisionit, përveç sa më sipër arsyetohet, t'i referohet ligjit nr. 84/2016, konkretisht nenit 27. Nëse rast se konstatohet që një subjekt rivlerësimi synon zvarritjen e procesit, Komisioni duhet t'i referohet nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit bashkëpunimi dhe sjellja e subjektit të rivlerësimit me Komisionin (apo Kolegjin) është faktor me rëndësi në vendimmarrjen gjatë procesit.
16. Për arsyet e shtjelluara më sipër, pakica është e mendimit që gabimi procedural i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mund të ishte korrigjuar nga trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nëpërmjet arsytimit të vendimit që do të merrej në dhomë këshillimi.
17. Në zbatim të nenit F, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit duhet të korrigjonte gabimin procedural, duke e konstatuar shkeljen e kryer nga Komisioni dhe duke e orientuar atë që në raste të ngjashme të zbatonte kërkesat e nenit 27 të ligjit nr. 84/2016.
18. Pakica bie dakord me vlerësimin e shumicës, sa i përket vlerësimit të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Në Komision ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk ka dhënë shpjegime bindëse, referuar pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të

ligjit nr. 84/2016 dhe parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës. Me të drejtë, Komisioni ka dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Lazaj, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

GJYQTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi